LIGJ
Nr. 108/2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 55/2020 "PËR SHËRBIMET E PAGESAVE"[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 55/2020 "Për shërbimet e pagesave" bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Nenet 1, 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

"Neni 1
Objekti

[1] Ky ligj është përafruar plotësisht me direktivën (BE) 2015/2366 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25 nëntor 2015 "Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm, dhe që ndryshon direktivat 2002/65/KE, 2009/110/KE dhe 2013/36/BE dhe rregulloren (BE) 1093/2010 dhe që shfuqizon direktivën 2007/64/KE", Numri CELEX 32015L 2366, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.337, datë 23.12.2015, faqe 35-127, e ndryshuar nga:
- Direktiva (BE) 2022/2556 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 14 dhjetor 2022, që ndryshon direktivat 2009/65/KE, 2009/138/KE, 2011/61/BE, 2013/36/BE, 2014/59/BE, 2014/65/BE, (BE) 2015/2366 dhe (BE) 2016/2341, në lidhje me qëndrueshmërinë operacionale digjitale për sektorin financiar numri CELEX 32022L2556, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.333, datë 27.12.2022, faqe 153-163;
- Rregullorja (BE) 2024/886 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 13 mars 2024 që ndryshon rregulloret (BE) 260/2012 dhe (BE) 2021/1230 dhe direktivat 98/26/KE dhe (BE) 2015/2366, në lidhje me transfertat e menjëhershme të kreditit në euro, CELEX: 32024R0886, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, L 2024/886, datë 19.3.2024.
- Ky ligj është përafruar plotësisht me direktivën 2009/110/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 16 shtator 2009 "Mbi krijimin, ushtrimin dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të veprimtarisë të institucioneve të parasë elektronike që ndryshon direktivat 2005/60/KE dhe 2006/48/KE dhe që shfuqizon direktivën 2000/46/EC", Numri CELEX 32009L0110, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 267, datë 10.10.2009, faqe 7–17, e ndryshuar nga:
- Direktiva (BE) 2015/2366 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25 nëntor 2015 "Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm, dhe që ndryshon direktivat 2002/65/KE, 2009/110/KE dhe 2013/36/BE dhe rregulloren (BE) 1093/2010 dhe që shfuqizon direktivën 2007/64/KE", Numri CELEX 32015L 2366, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr.337, datë 23.12.2015, faqe 35-127 .

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i kushteve dhe i rregullave për:

a) krijimin, licencimin, organizimin, ushtrimin e veprimtarisë, mbikëqyrjen dhe riorganizimin juridik të institucioneve të pagesave;

b) krijimin, licencimin, organizimin, ushtrimin e veprimtarisë, mbikëqyrjen dhe riorganizimin juridik të institucioneve të parasë elektronike;

c) transparencën e kushteve dhe kërkesat për informim për shërbimet e pagesave;

ç) të drejtat e detyrimet përkatëse të përdoruesve dhe të ofruesve të shërbimeve të pagesave, lidhur me ofrimin e shërbimeve të pagesave si një veprimtari e vazhdueshme ose aktivitet tregtar;

d) të drejtat e detyrimet përkatëse të mbajtësve dhe të emetuesve të parasë elektronike, lidhur me emetimin dhe ripagimin e fondeve të parasë elektronike.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kuadrit ligjor për shërbimet e pagesave dhe emetimin e parasë elektronike në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, në Bashkimin Evropian.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për shërbimet e pagesave të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të pagesave, të parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

2. Ofrues të shërbimeve të pagesave në territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

a) institucionet e kreditit, siç përcaktohen në legjislacionin e zbatueshëm për bankat, të licencuara nga Banka e Shqipërisë;

b) degët e institucioneve të kreditit, siç përcaktohen në legjislacionin e zbatueshëm për bankat, që e kanë zyrën qendrore në një vend të tretë, që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, institucionet e kreditit me zyrë qendrore në një shtet tjetër anëtar, të licencuara ose të autorizuara për ofrimin e shërbimeve të pagesave nga autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar të origjinës, duke përfshirë edhe degët e tyre, të krijuara në Republikën e Shqipërisë;

ç) institucionet e parasë elektronike të licencuara nga Banka e Shqipërisë;

d) degët e institucioneve të parasë elektronike që e kanë zyrën qendrore në një vend të tretë, siç parashikohet në nenin 28/6 të këtij ligji, që ofrojnë shërbime pagesash në territorin e Republikës së Shqipërisë për aq sa shërbimet e pagesave të ofruara nga këto degë janë të lidhura me emetimin e parasë elektronike;

dh) kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, institucionet e parasë elektronike me zyrë qendrore në një shtet tjetër anëtar, të licencuara ose të autorizuara nga autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar të origjinës, duke përfshirë edhe degët e tyre të krijuara

në Republikën e Shqipërisë, për aq sa shërbimet e pagesave të ofruara nga këto degë janë të lidhura me emetimin e parasë elektronike;

e) institucionet e pagesave të licencuara nga Banka e Shqipërisë;

ë) degët e institucioneve të pagesave që e kanë zyrën qendrore në një vend të tretë, siç parashikohet në nenin 26/7 të këtij ligji, që ofrojnë shërbime pagesash në territorin e Republikës së Shqipërisë;

f) kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, institucionet e pagesave me zyrë qendrore në një shtet tjetër anëtar, të licencuara ose të autorizuara nga autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar të origjinës, duke përfshirë edhe degët e tyre të krijuara në Republikën e Shqipërisë;

g) institucionet e shërbimeve postare, në rast se legjislacioni përkatës e parashikon ofrimin e shërbimeve të pagesave;

gj) Banka e Shqipërisë, kur nuk vepron në cilësinë e saj si autoritet monetar ose autoritete të tjera publike;

h) kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, Banka Qendrore Evropiane dhe banka të tjera qendrore të shteteve anëtare, kur nuk veprojnë në cilësinë e tyre si autoritete monetare ose autoritete të tjera publike;

i) autoritetet qendrore ose vendore të Republikës së Shqipërisë, kur nuk veprojnë në cilësinë e tyre si autoritete publike.

3. Institucionet dhe autoritetet e përcaktuara në shkronjat “gj”, “h” dhe “i” të pikës 2 dhe në shkronjat “ë”, “f” dhe “g” të pikës 4 të këtij neni, kur ofrojnë shërbime pagesash ose emetojnë para elektronike, brenda kompetencave të përcaktuara në këtë ligj, nuk zbatojnë përkatësisht dispozitat e titujve III e IV të këtij ligji dhe të seksionit 2 të kreut II të titullit II të këtij ligji, përveç rasteve kur përcaktohet shprehimisht në një akt nënligjor ose kontratë të veçantë lidhur me këto shërbime ose veprimtari.

4. Kreu II i titullit II të këtij ligji parashikon kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike, e cila në territorin e Republikës së Shqipërisë mund të ushtrohet nga kategoritë e mëposhtme të emetuesve të parasë elektronike:

a) institucionet e kreditit, siç përcaktohen në legjislacionin e zbatueshëm për bankat, të licencuara nga Banka e Shqipërisë;

b) degët e institucioneve të kreditit, siç përcaktohen në legjislacionin e zbatueshëm për bankat, që e kanë zyrën qendrore në një vend të tretë dhe ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, institucionet e kreditit me zyrë qendrore në një shtet tjetër anëtar, të licencuara ose të autorizuara për emetimin e parasë elektronike nga autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar të origjinës, duke përfshirë edhe degët e tyre të krijuara në Republikën e Shqipërisë;

ç) institucionet e parasë elektronike të licencuara nga Banka e Shqipërisë;

d) degët e institucioneve të parasë elektronike që e kanë zyrën qendrore në një vend të tretë, siç parashikohet në nenin 28/6 të këtij ligji, që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë;

dh) kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, institucionet e parasë elektronike me zyrë qendrore në një shtet tjetër anëtar, të licencuara ose të autorizuara nga autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar të origjinës, duke përfshirë edhe degët e tyre të krijuara në Republikën e Shqipërisë;

e) institucionet e shërbimeve postare, në rast se legjislacioni përkatës e parashikon emetimin e parasë elektronike;

ë) Banka e Shqipërisë, kur nuk vepron në cilësinë e saj si autoritet monetar ose autoritete të tjera publike;

f) kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, Banka Qendrore Evropiane dhe banka të tjera qendrore të shteteve anëtare, kur nuk veprojnë në cilësinë e tyre si autoritete monetare ose autoritete të tjera publike;

g) autoritetet qendrore ose vendore të Republikës së Shqipërisë kur veprojnë në cilësinë e tyre si autoritete publike.

5. Seksioni 1 i kreut II të titullit II të këtij ligji parashikon kërkesat për krijimin, ushtrimin e veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të parasë elektronike.

6. Dispozitat e titujve III dhe IV të këtij ligji do të zbatohen sipas përcaktimeve përkatëse të neneve 32 dhe 54 të këtij ligji.

7. Banka e Shqipërisë mund të përjashtojë plotësisht apo pjesërisht nga zbatimi i kërkesave të këtij ligji në lidhje me ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe/ose emetimin e parasë elektronike subjektet për të cilat ushtrimi i veprimtarisë dhe mbikëqyrja e tyre bëhen me ligj të veçantë dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, mund të përjashtojë plotësisht apo pjesërisht subjektet e referuara në nenin 2, pika 5, të Direktivës 2013/36/BE, nëse është e zbatueshme.

8. Ofruesit e shërbimeve të pagesave nuk lejohet të shmangen nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji, në dëm të përdoruesve të shërbimeve të pagesave, përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht në të. Pavarësisht sa parashikohet në këtë pikë, ofruesit e shërbimeve të pagesave mund të vendosin t'u ofrojnë kushte më të favorshme përdoruesve të shërbimeve të pagesave.

9. Emetuesit e parasë elektronike nuk lejohet të shmangen nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji, në dëm të mbajtësve të parasë elektronike, përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht në të. Pavarësisht sa parashikohet në këtë pikë, emetuesit e parasë elektronike mund të vendosin t'u ofrojnë kushte më të favorshme mbajtësve të parasë elektronike.".

Neni 2

Në nenin 4 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Paragrafi i parë numërtohet pika 1.

2. Shkronjat "e", "g" dhe "h" të pikës 1 ndryshohen si më poshtë:

"e) transaksionet e pagesave të bazuara në një nga dokumentet e mëposhtme, të lëshuara ndaj ofruesit të shërbimeve të pagesave, me qëllim vendosjen e fondeve në dispozicion të përfituesit të pagesës:

i. çeqe në formë letre, të rregulluara nga Konventa e Gjenevës e datës 19 mars 1931, që siguron një ligj të unifikuar për çeqet;

ii. çeqe në formë letre, të ngjashme me ato të përmendura në nënndarjen “i” të kësaj shkronje, të rregulluara nga ligjet e shteteve anëtare që nuk janë palë në Konventën e Gjenevës të datës 19 mars 1931, që parashikon një ligj të unifikuar për çeqet;

iii. urdhra pagese në formë letre, në përputhje me Konventën e Gjenevës të datës 7 qershor 1930, që parashikon një ligj të unifikuar për kambialet dhe letërpremtimet;

iv. urdhra pagese në formë letre, të ngjashme me ato të përmendura në nënndarjen “iii” të kësaj shkronje, të rregulluara nga ligjet e shteteve anëtare që nuk janë palë në Konventën e Gjenevës të datës 7 qershor 1930, që parashikon një ligj të unifikuar për kambialet dhe letërpremtimet;

v. kuponë në formë letre;

vi. çeqe udhëtarësh në formë letre;

vii. urdhra pagesash postare në formë letre, siç përcaktohen nga Unioni Universal Postar”.

“g) shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve teknike, të cilët mbështesin ofrimin e shërbimeve të pagesave, por që nuk zotërojnë në asnjë moment fondet që do të transferohen, duke përfshirë përpunimin e ruajtjen e të dhënave, shërbimet e besuara dhe të mbrojtjes së privatësisë, autentifikimin e të dhënave dhe të subjektit, teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit (TIK) dhe ofrimin e rrjetit të komunikimit, ofrimin dhe mirëmbajtjen e terminaleve dhe të pajisjeve që përdoren për shërbimet e pagesave, me përjashtim të shërbimit të inicimit të pagesës dhe shërbimit të informimit të llogarisë”.

“h) transaksionet e pagesave nga një ofrues i rrjeteve të komunikimeve elektronike ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike, të ofruara krahas shërbimeve të komunikimeve elektronike për një pajtimtar të rrjetit ose të shërbimit:

i. për blerjen e shërbimeve digjitale dhe shërbimeve zanore, pavarësisht nga pajisja që përdoret për blerjen ose konsumin e shërbimeve digjitale dhe të pasqyruara në faturën përkatëse; ose

ii. të realizuara nga ose nëpërmjet një pajisjeje elektronike dhe të pasqyruara në faturën përkatëse, në kuadër të një aktiviteti bamirësie ose për blerjen e biletave, me kusht që vlera e çdo transaksioni të vetëm pagese, të parashikuar në nënndarjet “i” dhe “ii” të kësaj shkronje, nuk e tejkalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës prej 50 eurosh dhe:

- vlera kumulative e transaksioneve të pagesave për një pajtimtar të vetëm nuk tejkalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 300 euro në muaj; ose

- vlera kumulative e transaksioneve të pagesave nuk tejkalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 300 euro në muaj, në rastet kur pajtimtari rimbush/parapaguan në llogarinë e tij me ofruesin e rrjetit të komunikimeve elektronike ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

3. Pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Kërkesat e kreut II të titullit II të këtij ligji dhe të akteve nënligjore për institucionet e parasë elektronike nuk do të zbatohen për:

a) vlerat monetare që ruhen në instrumente të përjashtuara, siç përcaktohen në shkronjën “gj” të pikës 1 të këtij neni;

b) vlerat monetare që përdoren për të kryer transaksione të pagesave të përjashtuara, siç përcaktohen në shkronjën “h” të pikës 1 të këtij neni.”.

Neni 3

Në nenin 5 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 3 fjala “të dhënave” zëvendësohet me fjalën “kredencialeve”.

2. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. “Degë” është njësia organizative, e ndryshme nga zyra qendrore, që është pjesë e një institucioni pagese ose institucioni të parasë elektronike, që nuk ka personalitet juridik e që kryen drejtpërdrejt disa ose të gjitha veprimtaritë për të cilat është licencuar institucioni i pagesave ose institucioni i parasë elektronike. Të gjitha njësitë organizative të krijuara në të njëjtin shtet anëtar pritës apo vend të tretë nga një institucion pagese ose institucion i parasë elektronike me zyrë qendrore në Republikën e Shqipërisë, do të konsiderohen si një degë e vetme. Të gjitha njësitë organizative të krijuara në Republikën e Shqipërisë nga një institucion pagese ose institucion i parasë elektronike me zyrë qendrore në një shtet tjetër anëtar ose vend të tretë do të konsiderohen si një degë e vetme.”.

3. Pas pikës 10 shtohet pika 10/1 me këtë përmbajtje:

“10/1. “Emetues i parasë elektronike” nënkupton subjektet e parashikuara në pikën 4 të nenit 3 të këtij ligji, institucionet që përfitojnë nga përjashtimet, sipas parashikimeve të pikës 7 të nenit 3, si dhe personat juridikë që përfitojnë nga përjashtimet, sipas parashikimeve të nenit 28/8 të këtij ligji.”.

4. Në pikën 11 fjalët “siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë” zëvendësohen me fjalët “siç përcaktohet në pikën 31/1 të këtij neni.”.

5. Pikat 12 dhe 13 ndryshohen si më poshtë:

“12. “Grup” është një grup shoqërish i përbërë nga shoqëria mëmë, shoqëritë e kontrolluara të saj, si dhe të gjitha subjektet mbi të cilat shoqëria mëmë apo shoqëria e kontrolluar e saj ushtron kontroll apo ku zotëron pjesëmarrje, si dhe shoqëritë që janë të lidhura nëpërmjet një marrëdhënieje të kontrollit të përbashkët, e përcaktuar si një marrëdhënie në bazë kontrate ose akte themeluese ose statutore, ose kur shumica e anëtarëve të organeve drejtuese janë të njëjtët persona gjatë vitit financiar dhe deri në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara.

13. “Institucion pagese” është personi juridik i licencuar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, për të ofruar dhe ekzekutuar shërbimet e pagesave, sipas aneksit 1 të këtij ligji, në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, në Bashkimin Evropian.”.

6. Pas pikës 13 shtohen pikat 13/1 dhe 13/2 me këtë përmbajtje:

“13/1. “Institucion i parasë elektronike” është personi juridik i licencuar nga Banka e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të kreut II të titullit II të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, për të ushtruar veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike.

13/2. “Institucion krediti” është personi juridik që ushtron veprimtari bankare dhe financiare, sipas përcaktimeve të legjislacionit të zbatueshëm për bankat në Republikën e Shqipërisë dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, do të ketë kuptimin sipas parashikimeve të nenit 4 (1), nënpika (1), të rregullores (BE) 575/2013. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, termi “bankë” nënkupton “institucion krediti” dhe anasjelltas.”.

7. Pas pikës 14 shtohet pika 14/1 me këtë përmbajtje:

“14/1. “Interes pjesëmarrës” nënkupton një interes në pjesëmarrje siç përcaktohet në legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, ose pronësinë direkte ose indirekte, të 20% ose më shumë të të drejtave të votës ose kapitalit të një shoqërie.”

8. Pika 16 ndryshohet si më poshtë:

“16. “Kapital rregullator (fondet e veta)” është shuma e kapitalit të nivelit të parë dhe kapitalit të nivelit të dytë, siç përcaktohet me akt nënligjor nga Banka e Shqipërisë dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, siç përcaktohet në pikën 118 të nenit 4(1) të rregullores (BE) 575/2013, ku të paktën 75% e kapitalit të nivelit të parë është në formën e kapitalit bazë të nivelit të parë dhe kapitali i nivelit të dytë është i barabartë ose më i vogël se 1/3 e kapitalit të nivelit të parë.”.

9. Në pikën 19 fjalia e fundit “Kontrata tip hartohet të paktën në gjuhën shqipe.” zëvendësohet me fjalinë “Kontrata tip hartohet në gjuhën shqipe ose në një gjuhë tjetër të dakordësuar midis palëve.”.

10. Pas pikës 19 shtohen pikat 19/1 dhe 19/2 me këtë përmbajtje:

“19/1. “Kontroll” nënkupton marrëdhënien midis një shoqërie mëmë dhe një filiali, siç parashikohet në legjislacionin e zbatueshëm për bankat.

19/2. “Kredenciale të personalizuara të sigurisë” janë elemente të personalizuara, të mundësuara nga ofruesi i shërbimeve të pagesave për përdoruesin e shërbimeve të pagesave, për qëllime autentifikimi.”.

11. Pas pikës 20 shtohet pika 20/1 me këtë përmbajtje:

“20/1. “Lidhje të ngushta” nënkupton një situatë në të cilën dy ose më shumë individë ose persona juridikë janë të lidhur nëpërmjet njërës nga mënyrat e mëposhtme:

a) pjesëmarrjes në formë pronësie, të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet kontrollit të 20% ose më shumë të të drejtave të votës ose kapitalit të një shoqërie;

b) kontrollit;

c) lidhjes së përhershme të dy individëve ose personave juridikë ose të të gjithë atyre me të njëjtin person të tretë nëpërmjet një marrëdhënieje kontrolli.”.

12. Pas pikës 31 shtohet pika 31/1 me këtë përmbajtje:

“31/1. “Para elektronike” nënkupton vlerën monetare të ruajtur në mënyrë elektronike, përfshirë edhe të ruajtur në mënyrë magnetike, e cila përfaqëson një pretendim ndaj emetuesit të parasë elektronike, që emetohet me pranimin e

fondeve për qëllime të kryerjes së transaksioneve të pagesës, siç përcaktohen në pikën 47 të këtij neni, dhe që është e pranuar nga persona fizikë apo juridikë, të ndryshëm nga emetuesi i parasë elektronike.”.

13. Në pikën 34 fjalët “që prodhohen e furnizohen në formë digjitale, përdorimi dhe” zëvendësohen me fjalët “që prodhohen e ofrohen në formë digjitale, përdorimi ose”.

14. Pas pikës 34 shtohet pika 34/1 me këtë përmbajtje:

“34/1. “Pjesëmarrje influencuese” nënkupton një zotërim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në një shoqëri, që përfaqëson 10% ose më shumë të kapitalit ose të të drejtave të votës ose që bën të mundur ushtrimin e një ndikimi të rëndësishëm mbi administrimin e asaj shoqërie.”.

15. Në pikën 35 fjala “transfertën” zëvendësohet me fjalën “transferimin”.

16. Në pikën 38 fjalët “me një ose disa ofrues të shërbimit të pagesave” zëvendësohen me fjalët “në një tjetër ofrues të shërbimit të pagesave ose në disa ofrues të shërbimit të pagesave”.

17. Pas pikës 40 shtohen pikat 40/1, 40/2 dhe 40/3 me këtë përmbajtje:

“40/1. “Shtet anëtar” është një shtet anëtar i Bashkimit Evropian ose një shtet palë në marrëveshjen për themelimin e Zonës Ekonomike Evropiane.

40/2. “Shtet anëtar i origjinës” nënkupton njërin nga të mëposhtmit:

a) shtetin anëtar në të cilin është vendosur selia e regjistruar e ofruesit të shërbimeve të pagesave; ose

b) nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave sipas ligjit të tij kombëtar nuk ka seli të regjistruar, shtetin anëtar në të cilin është vendosur zyra e tij qendrore.

40/3. “Shtet anëtar pritës” nënkupton shtetin anëtar të ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës, në të cilin ofruesi i shërbimeve të pagesave ka një agjent ose një degë ose ku ofron shërbime pagesash.”.

18. Në pikën 41 fjalët “përfshirje e një ose më shumë markave të pagesës ose aplikimeve të pagesave” zëvendësohen me fjalët “përfshirja e dy ose më shumë markave të pagesës ose aplikacioneve të pagesave”.

19. Pas pikës 43 shtohet pika 43/1 me këtë përmbajtje:

“43/1. “Tepricë mesatare e parasë elektronike” është mesatarja e shumës totale të detyrimeve financiare të lidhura me paranë elektronike të emetuar në fund të çdo dite kalendarike përgjatë 6-mujorit paraardhës. Teprica mesatare e parasë elektronike do të përllogaritet në ditën e parë kalendarike të çdo muaji kalendarik dhe do të aplikohet për atë muaj kalendarik.”.

20. Në pikën 44 fjalët “të dhënat e personalizuara” zëvendësohen me fjalët “kredencialet e personalizuara”.

21. Pika 45 shfuqizohet.

22. Pas pikës 47 shtohen pikat 47/1, 47/2 dhe 47/3 me këtë përmbajtje:

“47/1. “Transaksion pagese kombëtare (brenda vendit)” nënkupton një transaksion pagese, të ofruar nga ofruesi i shërbimeve të pagesave të një paguesi dhe/ose ofruesi i shërbimeve të pagesave të një përfituesi të pagesës në territorin e Republikës së Shqipërisë.

47/2. “Transaksion pagese ndërkombëtare” nënkupton një transaksion pagese ekzekutimi i të cilit përfshin dy ofrues të shërbimeve të pagesave, nga të cilët njëri ofrues i shërbimeve të pagesave e ofron këtë shërbim në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ofruesi tjetër i shërbimeve të pagesave ofron të njëjtin shërbim në territorin e një vendi të tretë, si dhe një transaksion pagese të ofruar nga një ofrues i shërbimeve të pagesave për një përdorues të shërbimeve të pagesave në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për të njëjtin përdorues ose për një përdorues tjetër të shërbimeve të pagesave në territorin e një vendi të tretë.

47/3. “Transaksion pagese ndërkufitare” nënkupton një transaksion pagese ekzekutimi i të cilit përfshin dy ofrues të shërbimeve të pagesave, nga të cilët njëri ofrues i shërbimeve të pagesave e ofron këtë shërbim në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ofruesi tjetër i shërbimeve të pagesave ofron të njëjtin shërbim në territorin e një shteti tjetër anëtar, si dhe një transaksion pagese të ofruar nga një ofrues i shërbimeve të pagesave për një përdorues të shërbimeve të pagesave në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për të njëjtin përdorues ose për një përdorues tjetër të shërbimeve të pagesave në territorin e një shteti tjetër anëtar.”.

23. Pas pikës 49 shtohet pika 50 me këtë përmbajtje:

“50. “Vend i tretë” nënkupton çdo shtet të huaj derisa Shqipëria të anëtarësohet në Bashkimin Evropian dhe, pas anëtarësimit, çdo shtet i cili nuk është shtet anëtar, në kuptim të pikës 40/1 të këtij neni.”.

Neni 4

Pas nenit 6 shtohet neni 6/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 6/1

Forma ligjore dhe emërtimi i institucionit të pagesave

1. Institucioni i pagesave me zyrë qendrore në Republikën e Shqipërisë themelohet si person juridik, bazuar në legjislacionin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, në formën e një shoqërie aksionare ose si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me përjashtim të ofruesve të shërbimit të informimit të llogarisë, të parashikuar në nenin 28 të këtij ligji.

2. Çdo ndryshim në formën ligjore ose në emërtimin e institucionit të pagesave i njoftohet Bankës së Shqipërisë. Në rastet e ndryshimit të formës ligjore nga shoqëri aksionare në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar kërkohet miratim nga Banka e Shqipërisë, e cila e bazon vendimin duke konsideruar volumin e veprimtarisë, kompleksitetin ose strukturën e subjektit.

3. Banka e Shqipërisë mund të rezervojë të drejtën që me akt nënligjor t’u kërkojë subjekteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni të ndryshojnë formën ligjore nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri aksionare, në varësi të volumit të veprimtarisë, kompleksitetit ose strukturës së subjektit.

4. Vetëm subjektet që janë licencuar nga Banka e Shqipërisë si institucione pagese kanë të drejtë të përdorin në emërtimin tregtar shprehjen “institucion

pagese” ose fjalë të prejardhura prej saj në ushtrimin e veprimtarisë apo shërbimeve të tyre ose ekuivalentin në gjuhë të huaj.

5. Dispozitat e parashikuara në këtë nen për institucionin e pagesave do të zbatohen me ndryshimet përkatëse (*mutatis mutandis)* edhe për institucionin e parasë elektronike, ku kudo ku citohet termi “institucion pagese” do të nënkuptojë/do të zëvendësohet me termin “institucion i parasë elektronike”.”.

Neni 5

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) një program të veprimtarive, duke përcaktuar në veçanti shërbimet e pagesave që parashikon të kryejë, sipas aneksit 1 të këtij ligji”;

b) në fund të shkronjës “c” shtohen fjalët “sipas parashikimeve të nenit 9 të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij”;

c) shkronjat “d” dhe “dh” ndryshohen si më poshtë:

“d) një përshkrim të mekanizmave qeverisës dhe të kontrollit të brendshëm të aplikuesit, duke përfshirë procedurat administrative të shoqërisë, procedurat e administrimit të rrezikut dhe procedurat kontabël, si dhe marrëveshjet kontraktuale për përdorimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, sipas përcaktimeve në kuadrin nënligjor për qëndrueshmërinë operacionale digjitale dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, siç përcaktohet në rregulloren (BE) 2022/2554, që tregon se mekanizmat qeverisës dhe të kontrollit të brendshëm janë proporcionalë, të përshtatshëm, të qëndrueshëm dhe të mjaftueshëm;

dh) një përshkrim të procedurave të vendosura për monitorimin, trajtimin dhe ndjekjen e një incidenti të sigurisë dhe të ankesave të klientëve që lidhen me sigurinë, duke përfshirë mekanizmin e raportimit të incidenteve, në përputhje me detyrimin për njoftim të institucioneve të pagesave, sipas kërkesave për administrimin, klasifikimin dhe raportimin e incidenteve të lidhur me TIK-un, të parashikuara në kuadrin nënligjor për qëndrueshmërinë operacionale digjitale dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, siç përcaktohet në kreun III të rregullores (BE) 2022/2554”;

ç) shkronja “ë” ndryshohet si më poshtë:

“ë) një përshkrim të masave për vazhdimësinë e biznesit, duke përfshirë një identifikim të qartë të operacioneve kritike, politikën dhe plane efektive për vazhdimësinë e biznesit në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, planet e reagimit dhe rimëkëmbjes të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe procedurën për të testuar dhe rishikuar rregullisht përshtatshmërinë dhe efikasitetin e këtyre planeve, sipas përcaktimeve në kuadrin nënligjor për qëndrueshmërinë operacionale digjitale dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, siç përcaktohet në rregulloren (BE) 2022/2554”.

d) në shkronjën “g” fjalët “shërbimet e pagesave, që ofron një përshkrim” zëvendësohen me fjalët “shërbimet e pagesave dhe një përshkrim ”.

dh) Në shkronjën “gj” fjalët “në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” zëvendësohen me fjalët “që aplikanti ka krijuar për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe për informacionin që shoqëron transfertat e fondeve ”.

e) në shkronjën “h” fjala “parashikimin” zëvendësohet me fjalët “një përshkrim të parashikimit”.

ë) në shkronjën “i” fjalët “sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për bankat, madhësinë e pjesëmarrjes në kapital dhe evidencë mbi reputacionin e tyre” zëvendësohen me fjalët “në kuptim të këtij ligji, madhësinë e pjesëmarrjes në kapital dhe evidencë mbi përshtatshmërinë dhe reputacionin e tyre”.

f) në shkronjën “j” pas fjalëve “si dhe informacion për kualifikimin” shtohet fjala “njohuritë”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Për qëllimet e shkronjave “ç”, “d”, “dh” dhe “h” të pikës 1 të këtij neni, aplikuesi paraqet edhe një përshkrim të mekanizmave të kontrollit dhe të strukturave organizative të krijuara, me synimin për të ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të mbrojtur interesat e përdoruesve të tij dhe për të siguruar vazhdimësinë dhe besueshmërinë në ofrimin e shërbimeve të pagesave.

Kontrolli i sigurisë dhe masat zbutëse të marra, të parashikuara në shkronjën “g” të pikës 1 të këtij neni, duhet të tregojnë se si ato sigurojnë një nivel të lartë të qëndrueshmërisë operacionale digjitale, në përputhje me kërkesat për administrimin e rrezikut të TIK-ut, të parashikuara në kuadrin nënligjor për qëndrueshmërinë operacionale digjitale dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, siç përcaktohet në kreun II të rregullores (BE) 2022/2554, veçanërisht në lidhje me sigurinë teknike dhe mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe programet kompjuterike dhe sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, të përdorura nga aplikuesi ose nga palët e treta, të cilave iu transferohen pjesërisht apo plotësisht operacionet. Këto masa duhet gjithashtu të përfshijnë edhe masat e sigurisë, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 88 të këtij ligji. Masat duhet të marrin parasysh aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, udhëzuesit e Autoritetit Bankar Evropian për masat e sigurisë, të parashikuara në pikën 3 të nenit 88 të këtij ligji, kur janë të zbatueshme.”.

3. Në pikën 2 fjalët “të ketë një siguracion dëmshpërblimi profesional ose ndonjë garanci tjetër të krahasueshme për të siguruar që subjekti mund të mbulojë detyrimet e tij të përcaktuara në nenet 66, 82, 83 dhe 85 të këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “të ketë një siguracion dëmshpërblimi profesional që mbulon territoret ku ofron shërbime ose ndonjë garanci tjetër të krahasueshme kundrejt përgjegjësive për të siguruar që subjekti mund të mbulojë detyrimet e tij të përcaktuara në nenet 66, 83 dhe 85 të këtij ligji”.

4. Në pikën 3 fjalët “të ketë një siguracion dëmshpërblimi profesional ose ndonjë garanci tjetër të krahasueshme kundrejt përgjegjësisë së tij ndaj ofruesit të

shërbimit të llogarisë së shërbimit të pagesave ose përdoruesit të shërbimit të pagesave" zëvendësohen me fjalët "të ketë një siguracion dëmshpërblimi profesional që mbulon territoret ku ofron shërbime ose ndonjë garanci tjetër të krahasueshme kundrejt përgjegjësisë së tij ndaj ofruesit të shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë ose ndaj përdoruesit të shërbimit të pagesave".

5. Në fund të pikës 4 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Në hartimin e akteve nënligjore Banka e Shqipërisë bazohet në udhëzuesit e Autoritetit Bankar Evropian dhe merr në konsideratë:

a) profilin e rrezikut të subjektit;

b) nëse subjekti ofron shërbime të tjera pagesash, të parashikuara në aneksin 1 të këtij ligji, ose është përfshirë në veprimtari të tjera tregtare;

c) madhësinë e veprimtarisë:

i. për subjektet që aplikojnë për licencim për të ofruar shërbimet e pagesave sipas pikës 7 të aneksit 1 të këtij ligji vlerën e transaksioneve të iniciuara;

ii. për subjektet që aplikojnë për regjistrim për të ofruar shërbimet e pagesave sipas pikës 8 të aneksit 1 të këtij ligji, numrin e klientëve që përdorin shërbimin e informimit të llogarisë;

ç) karakteristikat specifike të garancive të krahasueshme dhe kriteret për zbatimin e tyre.".

6. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

"4/1. Informacioni i parashikuar në pikën 4 të këtij neni i paraqitet Bankës së Shqipërisë, në përputhje me kërkesat e pikës 1 të këtij neni.".

Neni 6

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 fjalët "në kuptimin e legjislacionit në fuqi për bankat" zëvendësohen me fjalët "në kuptim të këtij ligji".

2. Në pikën 2 fjalët "dokumentacionin dhe informacionin përkatës, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë " zëvendësohen me fjalët "si dhe dokumentacionin dhe informacionin përkatës, sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin e zbatueshëm për bankat në lidhje me zotërimin e pjesëmarrjes influencuese në një institucion krediti dhe në aktet nënligjore përkatëse të dala në zbatim të atyre kërkesave".

3. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen si më poshtë:

"3. Banka e Shqipërisë, kur gjykon se influenca e ushtruar nga një blerës i propozuar, siç parashikohet në pikën 2 të këtij neni, mund të dëmtojë administrimin e kujdesshëm dhe të qëndrueshëm të institucionit të pagesave, brenda 3 muajve nga data e plotësimit të kërkesave të përcaktuara në këtë nen kundërshton ndryshimin e pjesëmarrjes influencuese ose merr masa të tjera të përshtatshme për ta përfunduar këtë situatë. Këto masa mund të përfshijnë urdhra, sanksione ndaj administratorëve ose personave përgjegjës për administrimin e subjektit ose pezullimin e ushtrimit të të drejtave të votës që lidhen me aksionet ose kuotat e mbajtura nga aksionarët ose ortakët e institucionit të pagesave. Masa të

ngjashme do të zbatohen edhe ndaj personave fizikë ose juridikë që nuk informojnë paraprakisht me shkrim Bankën e Shqipërisë, siç parashikohet në këtë nen.

4. Çdo pjesëmarrje që fitohet në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji është absolutisht e pavlefshme.”.

4. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Nëse pjesëmarrja influencuese zotërohet pavarësisht kundërshtimit të Bankës së Shqipërisë, sipas pikës 3 të këtij neni, përveç çdo sanksioni tjetër që mund të vendoset, Banka e Shqipërisë urdhëron pezullimin e ushtrimit të të drejtave përkatëse të votës, pavlefshmërinë e votave të dhëna ose mundësinë e anulimit të këtyre votave.”.

Neni 7

Nenet 9, 10 dhe 11 ndryshohen si më poshtë:

“Neni 9

Kapitali fillestar minimal

1. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor shumën e kapitalit fillestar minimal të kërkuar për institucionin e pagesave dhe përcakton elementet përbërëse të tij.

2. Kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, për t’u licencuar si institucion pagesash, subjekti duhet të plotësojë shumat e mëposhtme të kapitalit fillestar:

a) kur institucioni i pagesave do të ofrojë vetëm shërbimin e pagesave, të parashikuar në pikën 6 të aneksit 1 të këtij ligji, jo më pak se vlerën ekuivalente në lekë të shumës 20 000 euro;

b) kur institucioni i pagesave do të ofrojë vetëm shërbimin e pagesave, të parashikuar në pikën 7 të aneksit 1 të këtij ligji, jo më pak se vlerën ekuivalente në lekë të shumës 50 000 euro;

c) kur institucioni i pagesave do të ofrojë shërbimet e pagesave, të parashikuara në pikat 1-5 të aneksit 1 të këtij ligji, jo më pak se vlerën ekuivalente në lekë të shumës 125 000 euro.

3. Deri në anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, subjektet që kërkojnë të licencohen si institucione pagesash plotësojnë shumat minimale të kapitalit fillestar, të parashikuara në aktin nënligjor përkatës të Bankës së Shqipërisë.

Neni 10

Fondet e veta

1. Fondet e veta të institucionit të pagesave nuk mund të bien nën shumën e kapitalit fillestar minimal, të përcaktuar sipas nenit 9 të këtij ligji, ose nën vlerën e fondeve të veta, të llogaritur sipas metodave të parashikuara në nenin 11 të këtij ligji, cilado qoftë më e lartë.

2. Përdorimi i shumëfishtë i elementeve të kualifikuara si fonde të veta është i ndaluar, në rastet kur institucioni i pagesave i përket të njëjtit grup me një institucion tjetër pagese, një institucion krediti, një shoqëri komisionere, një shoqëri administruese apo një shoqëri sigurimi. Ky ndalim zbatohet edhe në rastet kur institucioni i pagesave ka karakter hibrid dhe kryen edhe veprimtari të tjera, të ndryshme nga ato të shërbimeve të pagesave, siç parashikohen në shkronjën "c" të pikës 1 të nenit 19 të këtij ligji. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të përcaktojë masat e nevojshme që duhet të merren nga institucioni i pagesave për të parandaluar përdorimin e shumëfishtë të elementeve të kualifikuara si fonde të veta.

3. Banka e Shqipërisë mund të vendosë të përjashtojë nga zbatimi i kërkesave të nenit 11 të këtij ligji një institucion pagesash që është pjesë e mbikëqyrjes së konsoliduar të një institucioni krediti mëmë, të licencuar nga Banka e Shqipërisë sipas legjislacionit të zbatueshëm për bankat, në rast se plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 7 të rregullores (BE) 575/2013, të cilat garantojnë shpërndarjen e mjaftueshme të kapitalit midis institucionit mëmë dhe institucionit të pagesave.

Neni 11
Llogaritja e fondeve të veta

1. Banka e Shqipërisë, pavarësisht kërkesave për kapital fillestar minimal, të parashikuara në nenin 9 të këtij ligji dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, përcakton me akt nënligjor përbërjen dhe vlerën e fondeve të veta, të detyrueshme për t'u mbajtur në çdo kohë nga institucionet e pagesave, përveç institucioneve të pagesave që ofrojnë shërbimet, sipas pikës 7 ose 8 ose të dyja njëkohësisht, sipas aneksit 1 të këtij ligji. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor metodën e zbatueshme për llogaritjen e vlerës së fondeve të veta, sipas njërës nga tri metodat e parashikuara si më poshtë:

Metoda A

Vlera e fondeve të veta të institucionit të pagesave duhet të jetë të paktën sa 10 % e shpenzimeve fikse të veprimtarisë së tij të vitit paraardhës. Banka e Shqipërisë mund ta rregullojë këtë kërkesë në rast të një ndryshimi material në veprimtarinë e institucionit të pagesës krahasuar me vitin paraardhës. Kur një institucion pagesash nuk ka përfunduar një vit të plotë ushtrimi në datën e llogaritjes, vlera e fondeve të veta do të jetë të paktën sa 10 % e shpenzimeve fikse të veprimtarisë përkatëse, sipas parashikimeve në planin e tij të biznesit, përveç rasteve kur Banka e Shqipërisë ka kërkuar rishikimin e këtij plani.

Metoda B

Vlera e fondeve të veta të institucionit të pagesave duhet të jetë të paktën sa shuma e elementeve të mëposhtme, e shumëzuar me faktorin e përshkallëzuar "k", të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni:

i. 4,0% e pjesës së VP-ve deri në vlerën ekuivalente në lekë të shumës 5 milionë euro; plus

ii. 2,5% të pjesës së VP-ve mbi vlerën ekuivalente në lekë të shumës 5 milionë euro deri në 10 milionë euro; plus

iii. 1% të pjesës së VP-ve mbi vlerën ekuivalente në lekë të shumës 10 milionë euro deri në 100 milionë euro; plus

iv. 0,5% të pjesës së VP-ve mbi vlerën ekuivalente në lekë të shumës 100 milionë euro deri në 250 milionë euro; plus

v. 0,25% të pjesës së VP-ve mbi vlerën ekuivalente në lekë të shumës 250 milionë euro, ku VP është vëllimi i pagesave, i cili përfaqëson 1/12 e shumës totale të transaksioneve të pagesave të ekzekutuara nga institucioni i pagesave në vitin paraardhës.

Metoda C

Vlera e fondeve të veta të institucionit të pagesave duhet të jetë të paktën sa treguesi përkatës, i përcaktuar në shkronjën "a", i shumëzuar me faktorin shumëzues të përcaktuar në shkronjën "b" dhe me faktorin e përshkallëzuar "k", të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

a) treguesi përkatës është shuma e elementeve të mëposhtme:

i. të ardhurave nga interesat;

ii. shpenzimeve për interesa;

iii. komisioneve dhe tarifave të marra; dhe

iv. të ardhurave të tjera të veprimtarisë.

Çdo element i parashikuar në shkronjën "a" përfshihet në llogaritjen e shumës, me shenjën e tij pozitive ose negative. Të ardhurat e jashtëzakonshme ose të parregullta nuk do të përfshihen në llogaritjen e treguesit përkatës. Shpenzimet për marrëveshjet me palë të treta për ofrimin e shërbimeve mund të zbriten nga treguesi përkatës, nëse këto shpenzime i paguhen një subjekti që gjithashtu i nënshtrohet mbikëqyrjes sipas këtij ligji. Treguesi përkatës llogaritet në fund të vitit financiar paraardhës mbi bazën e të dhënave mujore për atë periudhë. Treguesi përkatës llogaritet për vitin financiar paraardhës.

Në çdo rast fondet e veta të llogaritura sipas metodës C nuk duhet të bien nën 80% të mesatares së treguesit përkatës për 3 vjetët financiarë paraardhës. Kur shifrat e audituara nuk janë të disponueshme, institucioni i pagesave mund të përdorë vlerësimet e tij.

b) faktori shumëzues do të jetë:

i. 10% e pjesës së treguesit përkatës deri në vlerën ekuivalente në lekë të shumës 2,5 milionë euro;

ii. 8% e pjesës së treguesit përkatës nga vlera ekuivalente në lekë e shumës 2,5 milionë euro deri në vlerën ekuivalente në lekë të shumës 5 milionë euro;

iii. 6% e pjesës së treguesit përkatës nga vlera ekuivalente në lekë e shumës 5 milionë euro deri në vlerën ekuivalente në lekë të shumës 25 milionë euro;

iv. 3% e pjesës së treguesit përkatës nga vlera ekuivalente në lekë e shumës 25 milionë euro deri në vlerën ekuivalente në lekë të shumës 50 milionë euro;

v. 1,5% e pjesës së treguesit përkatës mbi vlerën ekuivalente në lekë të shumës 50 milionë euro.

2. Faktori i përshkallëzuar “k” që përdoret për metodën B dhe metodën C, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, është:

i. 0,5 kur institucioni i pagesave ofron vetëm shërbimin e pagesave, të parashikuar në pikën 6 të aneksit 1 të këtij ligji;

ii. 1 kur institucioni i pagesave ofron shërbimet e pagesave, të parashikuara në pikat 1-5, të aneksit 1 të këtij ligji.

3. Banka e Shqipërisë, bazuar në një vlerësim të proceseve të administrimit të rrezikut, bazës së të dhënave të humbjeve dhe të mekanizmave të kontrollit të brendshëm të institucionit të pagesave, mund t’i kërkojë institucionit të pagesave që të mbajë një shumë të fondeve të veta deri në 20% më të lartë se vlera e llogaritur nga aplikimi i metodës së përcaktuar në aktin nënligjor të Bankës së Shqipërisë ose të lejojë institucionin e pagesave që të mbajë një shumë të fondeve të veta deri në 20% më të ulët se vlera e llogaritur nga aplikimi i metodës së përcaktuar në aktin nënligjor të Bankës së Shqipërisë, siç parashikohet në pikën 1 të këtij neni.

4. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor kriteret dhe kërkesat që duhet të plotësohen nga institucioni i pagesave për të lejuar këtë të fundit që të mbajë një shumë të fondeve të veta deri në 20% më të ulët se vlera e llogaritur nga aplikimi i metodës së përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, siç parashikohet në pikën 3 të këtij neni.”.

Neni 8

Pika 1 e nenit 12 ndryshohet si më poshtë:

“1. Institucionet e pagesave që ofrojnë shërbimet e pagesave, sipas pikave 1 deri në 6 të aneksit 1 të këtij ligji, dhe institucionet e parasë elektronike, siç përcaktohen në pikën 13/1 të nenit 5 të këtij ligji, i mbrojnë të gjitha fondet e marra prej përdoruesve të shërbimeve të pagesave ose nëpërmjet një ofruesi tjetër të shërbimeve të pagesave për kryerjen e transaksioneve të pagesave në njërën nga mënyrat e mëposhtme:

a) fondet nuk duhet të bashkohen në asnjë rast me fondet e vetë institucionit të pagesave apo të ndonjë personi fizik apo juridik, të ndryshëm nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave në emër të të cilëve janë mbajtur fondet, dhe, në rastet kur ato ende mbahen nga institucioni i pagesave ose institucioni i parasë elektronike dhe nuk janë dorëzuar ende te përfituesi i pagesës ose nuk janë transferuar ende te një ofrues tjetër i shërbimeve të pagesave deri në fund të ditës së punës që pason ditën kur fondet janë pranuar, fondet do të depozitohen në një llogari të veçantë në një institucion krediti në Republikën e Shqipërisë ose në Bankën e Shqipërisë, sipas diskrecionit të Bankës së Shqipërisë dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, në një institucion krediti të licencuar në një shtet anëtar ose në bankën qendrore të një shteti anëtar, sipas diskrecionit të saj, ose do të investohen në aktive të sigurta, likuide me rrezik të ulët, siç përcaktohet me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë~~;~~ dhe fondet do të mbrohen në përputhje me këtë ligj dhe çdo ligj tjetër në fuqi, në interes të përdoruesve të shërbimeve të pagesave ndaj pretendimeve të kreditorëve

të tjerë të institucionit të pagesave ose institucionit të parasë elektronike, veçanërisht në rast të falimentimit të tyre. Fondet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave, pavarësisht mënyrës së zgjedhur për mbrojtjen e fondeve, në asnjë rast nuk mund të bllokohen, të jenë objekt i pretendimeve të çdolloj kreditori të institucionit të pagesave ose institucionit të parasë elektronike apo t'i nënshtrohen ekzekutimit të detyrueshëm të institucionit. Në rast falimentimi të institucionit të pagesave ose institucionit të parasë elektronike, këto fonde nuk bëjnë pjesë në masën e falimentit dhe u shpërndahen përdoruesve të shërbimeve të pagesave në mënyrë proporcionale;

b) fondet mbulohen me një policë sigurimi ose me ndonjë garanci tjetër të krahasueshme me të nga një shoqëri sigurimi ose nga një institucion krediti në Republikën e Shqipërisë, që nuk i përket të njëjtit grup të institucionit të pagesave ose institucionit të parasë elektronike, për një shumë të barasvlershme me atë që do të ishte veçuar në mungesë të policës së sigurimit ose të garancisë tjetër të krahasueshme. Polica e sigurimit ose garancia tjetër e krahasueshme me të është e pagueshme në rast se institucioni i pagesave ose institucioni i parasë elektronike nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tij financiare ndaj përdoruesve të shërbimeve të pagesave.".

Neni 9

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

"1. Subjektet të cilat synojnë të ofrojnë shërbime pagese duhet të marrin licencë si një institucion pagese para se të fillojnë ofrimin e shërbimeve të pagesave. Këtu bëjnë përjashtim subjektet e përmendura në shkronjat "a" deri në "dh" dhe "g" deri në "i" të pikës 2 të nenit 3 të këtij ligji dhe personat fizikë ose juridikë që përfitojnë nga përjashtimi, sipas neneve 27 ose 28 të këtij ligji. Licenca mund t'i jepet vetëm një personi juridik të themeluar në Republikën e Shqipërisë.

2. Banka e Shqipërisë i jep licencën aplikantit nëse informacioni dhe dokumentacioni që shoqërojnë kërkesën janë në përputhje me të gjitha kërkesat e nenit 7 të këtij ligji dhe nëse vlerësimi i përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë pas shqyrtimit të aplikimit është pozitiv. Përpara dhënies së licencës Banka e Shqipërisë, kur e gjykon të nevojshme, mund të konsultohet me autoritete të tjera publike përkatëse.".

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

"2/1. Banka e Shqipërisë, në rolin e autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar të origjinës, i jep licencën subjektit që aplikon për licencim si institucion pagesash, vetëm nëse ky subjekt është i regjistruar dhe ka zyrën qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe do të kryejë të paktën një pjesë të veprimtarisë të shërbimeve të pagesave brenda këtij territori.".

3. Pas pikës 7 shtohen pikat 8 dhe 9 me këtë përmbajtje:

"8. Banka e Shqipërisë i jep licencën institucionit të pagesave vetëm nëse ligjet, rregulloret ose aktet juridike të një vendi të tretë, që rregullojnë një ose më shumë

persona fizikë ose juridikë, me të cilët institucioni i pagesave ka lidhje të ngushta, ose vështirësitë në zbatimin e këtyre ligjeve, rregulloreve ose aktet juridike nuk pengojnë ushtrimin efektiv të funksioneve të saj mbikëqyrëse. Për qëllime të kësaj pike, Banka e Shqipërisë bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse të vendit të tretë.

9. Licenca e dhënë nga Banka e Shqipërisë është e vlefshme në të gjitha shtetet anëtare dhe e lejon institucionin e pagesave të ofrojë shërbimet e pagesave të përcaktuara në aneksin e licencës në të gjithë Bashkimin Evropian, në përputhje me lirinë për të ofruar shërbime ose të drejtën e vendosjes.”.

Neni 10

Pas pikës 2 të nenit 14 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Banka e Shqipërisë publikon në Buletinin Zyrtar dhe faqen e saj të internetit vendimin për dhënien e licencës për të vepruar si institucion i pagesave.”.

Neni 11

Në shkronjën “dh” të pikës 1 të nenit 15 pas fjalëve “ka prova të besueshme” shtohen fjalët “ose dyshime të arsyeshme” dhe pas fjalës “aksionarët” shtohet fjala “/ortakët”.

Neni 12

Pas nenit 15 shtohet neni 15/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 15/1

Pasojat e shfuqizimit të licencës

1. Institucioni i pagesave nuk mund të ushtrojë më veprimtaritë ose shërbimet për të cilat ishte licencuar dhe nuk mund të lidhë më kontrata të reja për këto veprimtari apo shërbime pas shfuqizimit të licencës.

2. Shfuqizimi i licencës nuk e bën të pavlefshme një marrëveshje, transaksion ose veprim të kryer nga institucioni i pagesave përpara shfuqizimit të licencës dhe nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e asnjë personi, që lindin nga marrëveshja, transaksioni apo veprimi në fjalë.

3. Pas shfuqizimit të licencës institucioni i pagesave nuk mund të ndryshojë asnjë nga kushtet e kontratave ekzistuese me klientët për veprimtaritë dhe shërbimet financiare për të cilat ka qenë i licencuar.

4. Institucioni i pagesave, në rastin e shfuqizimit të licencës si rrjedhojë e kërkesës vullnetare të tij ose të shfuqizimit nga ana e Bankës së Shqipërisë si një masë mbikëqyrëse, paraqet në Bankën e Shqipërisë një plan veprimi. Plani i veprimit duhet të parashikojë masat që do të merren nga institucioni i pagesave deri në përfundimin e marrëdhënieve kontraktore me klientët të cilët kanë përfituar nga veprimtaritë dhe shërbimet financiare të ofruara nga institucioni i

pagesave, përfshirë mënyrën dhe afatet e rimbursimit të fondeve të klientëve. Në rast se institucioni i pagesave, për shkak të natyrës së veprimtarisë dhe shërbimit financiar që ushtron, nuk ka kontrata të cilat vazhdojnë edhe pas shfuqizimit të licencës, nuk paraqet një plan veprimi.

5. Aksionarët ose ortakët, anëtarët e organeve drejtuese dhe administratori i institucionit të pagesave duhet të bashkëpunojnë me Bankën e Shqipërisë pas shfuqizimit të licencës deri në momentin e përfundimit të kontratave që institucioni i pagesave ka lidhur si rrjedhojë e ushtrimit të veprimtarive dhe shërbimeve financiare për të cilat ishte licencuar.

6. Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë për institucionin e pagesave, aksionarët ose ortakët, anëtarët e organeve drejtuese dhe/ose administratorin e institucionit të pagesave, nëse ata nuk bashkëpunojnë me Bankën e Shqipërisë, siç parashikohet në pikën 5 të këtij neni, ose nëse kryejnë ndonjë nga shkeljet e parashikuara në nenin 94 të këtij ligji, edhe gjatë periudhës pas shfuqizimit të licencës deri në momentin e përfundimit të kontratave që institucioni i pagesave ka lidhur si rrjedhojë e ushtrimit të veprimtarive dhe shërbimeve financiare për të cilat ishte licencuar.

7. Në rastet kur licenca e institucionit të pagesave shfuqizohet si rrjedhojë e fillimit të procedurave të falimentit ose procedura e falimentit fillon pas shfuqizimit të licencës, sipas legjislacionit për falimentin, Banka e Shqipërisë dhe administratori i falimentit bashkëpunojnë, me qëllim përcaktimin e mënyrës së administrimit të kontratave financiare, të cilat subjekti i ka lidhur si rrjedhojë e ushtrimit të veprimtarive dhe shërbimeve financiare për të cilat ishte licencuar dhe janë ende në fuqi ose të paekzekutuara në momentin e fillimit të procedurës së falimentit.

8. Fondet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave dhe fondet e marra në këmbim të emetimit të parasë elektronike nuk përfshihen në masën e falimentit përkatësisht të institucionit të pagesave dhe të institucionit të parasë elektronike. Këto fonde nuk mund të përdoren për të paguar kreditorët e tjerë të institucionit të pagesave ose të institucionit të parasë elektronike.

9. Klientët kanë përparësi absolute për rimbursimin e fondeve të tyre ndaj çdo kreditori tjetër.”.

Neni 13

Në nenin 16 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i nenit ndryshohet dhe bëhet “Regjistri publik dhe paraqitja e informacionit tek Autoriteti Bankar Evropian”.

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Banka e Shqipërisë krijon dhe mban një regjistër publik, në të cilin regjistron:

a) institucionet e pagesave të licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe agjentët e tyre;

b) personat fizikë dhe juridikë të cilët përfitojnë nga përjashtimet, sipas përcaktimeve në nenet 27 ose 28 të këtij ligji, dhe agjentët e tyre;

c) institucionet e parasë elektronike, të licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe agjentët e tyre;

ç) personat të cilët përfitojnë nga përjashtimet, sipas përcaktimeve në nenin 28/8 të këtij ligji, dhe agjentët e tyre;

d) subjektet e parashikuara në pikën 7 të nenit 3 të këtij ligji të cilët ofrojnë shërbime pagesash.”.

3. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Banka e Shqipërisë përfshin në regjistrin publik të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, edhe degët e institucioneve të pagesave dhe të institucioneve të parasë elektronike të licencuara nga Banka e Shqipërisë, të cilat ofrojnë shërbime pagesash ose shërbime të parasë elektronike në një shtet tjetër anëtar ose në një vend të tretë.”.

4. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Regjistri specifikon shërbimet e pagesave ose shërbimet e parasë elektronike për të cilat subjektet ose personat e parashikuar në pikat 1 dhe 1/1 të këtij neni janë licencuar ose regjistruar. Institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike të licencuara renditen në regjistër veçmas nga personat që përfitojnë nga përjashtimet, sipas neneve 27, 28 dhe 28/8 të këtij ligji. Regjistri mbahet për konsultim nga publiku, publikohet dhe është i aksesueshëm në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë dhe përditësohet pa vonesa.”.

5. Në pikën 3 fjalët “sipas neneve 27 dhe 28” zëvendësohen me fjalët “sipas neneve 27, 28 dhe 28/8”.

6. Pas pikës 4 shtohen pikat 5, 6, 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:

“5. Banka e Shqipërisë njofton Autoritetin Bankar Evropian në gjuhën e standardit financiar, pa vonesë dhe sipas formatit të përcaktuar nga Autoriteti Bankar Evropian, për çdo subjekt apo informacion që përfshin në regjistrin e saj publik, sipas parashikimeve të pikave 1, 1/1 dhe 2 të këtij neni.

6. Banka e Shqipërisë njofton Autoritetin Bankar Evropian për çdo shfuqizim licence ose regjistrimi, si dhe lidhur me çdo përjashtim, sipas përcaktimeve të neneve 27, 28 dhe 28/8 të këtij ligji, sipas formatit të përcaktuar nga Autoriteti Bankar Evropian.

7. Banka e Shqipërisë siguron saktësinë e informacionit që i paraqet Autoritetit Bankar Evropian, sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 6 të këtij neni, si dhe përditësimin e këtij informacioni.

8. Banka e Shqipërisë, për qëllime të zbatimit të këtij neni, konsideron edhe standardet teknike të miratuara nga Komisioni Evropian, në përputhje me nenin 15, pikat 4 dhe 5, të direktivës (BE) 2015/2366.”.

Neni 14

Në nenin 19 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Institucionet e pagesave, krahas ofrimit të shërbimeve të pagesave, mund të kryejnë edhe veprimtaritë e mëposhtme:

a) shërbime operacionale dhe ndihmëse, të lidhura ngushtë me shërbimet e pagesave, si ato që mundësojnë ekzekutimin e transaksioneve të pagesave, shërbimet e këmbimit valutor, veprimtaritë e ruajtjes së fondeve, si dhe ruajtjen e përpunimin e të dhënave;

b) operimin e sistemeve të pagesave, sipas nenit 20 të këtij ligji dhe pa cenuar pjesëmarrjen e tyre në sisteme të tjera, sipas nenit 29 të këtij ligji;

c) veprimtari tregtare, të ndryshme nga ato të ofrimit të shërbimit të pagesave, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, edhe në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Fondet e marra nga institucionet e pagesave prej përdoruesve të shërbimeve të pagesave, me qëllim ofrimin e shërbimeve të pagesave, nuk janë depozita apo fonde të tjera të ripagueshme, sipas kuptimit të legjislacionit të zbatueshëm për bankat, dhe as para elektronike, në kuptim të këtij ligji.”.

2. Shkronja “ç” e pikës 4 ndryshohet si më poshtë:

“ç) fondet e veta të institucionit të pagesave në çdo kohë duhet të jenë të mjaftueshme për të mbuluar rreziqet që lidhen me dhënien e kredisë dhe në përputhje me kërkesat mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë.”.

4. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Institucioni i pagesave për kreditë e dhëna konsumatorëve, sipas pikës 4 të këtij neni, zbaton edhe kërkesat e legjislacionit shqiptar lidhur me kushtet e dhënies së kredive konsumatore të cilat nuk janë të rregulluara nga ky ligj.”.

5. Pika 7 shfuqizohet.

Neni 15

Në nenin 21 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i nenit ndryshohet dhe bëhet “Ofrimi i shërbimeve nëpërmjet agjentëve dhe degëve, si dhe marrëveshjet me të tretët (*outsourcing*)”.

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kur institucioni i pagesave synon të ofrojë shërbimet e pagesave nëpërmjet agjentit, ai njofton Bankën e Shqipërisë dhe i paraqet informacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe adresën e agjentit;

b) një përshkrim të mekanizmave të kontrollit të brendshëm që do të përdoren nga agjenti, në përputhje me detyrimet e legjislacionit shqiptar, lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, që duhet të përditësohet pa vonesë në rast të ndryshimeve të rëndësishme në të dhënat e komunikuara në njoftimin fillestar;

c) identitetin e administratorit dhe të personave përgjegjës për administrimin e veprimtarisë së shërbimeve të pagesave që agjenti do të kryejë në emër dhe për llogari të institucionit të pagesave dhe për agjentët, të ndryshëm nga ofruesit e

shërbimeve të pagesave, dëshmi që janë persona të përshtatshëm, siç përcaktohet në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë;

ç) shërbimet e pagesave që do të kryejë agjenti;

d) kur është e zbatueshme, kodin unik të identifikimit ose NUIS, ose numrin e agjentit.”.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Para se agjenti të listohet në regjistër, nëse Banka e Shqipërisë konsideron që informacioni i paraqitur nuk është i saktë, ajo bën verifikimin e këtij informacioni.”.

4. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Nëse institucioni i pagesave kërkon të ofrojë shërbime pagesash në një shtet tjetër anëtar nëpërmjet angazhimit të një agjenti apo nëpërmjet krijimit të një dege, ai duhet të ndjekë procedurat e parashikuara në nenin 26/3 të këtij ligji.”.

5. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të refuzojë brenda 3 muajve nga marrja dijeni marrëveshjen me të tretët për transferimin e funksioneve të rëndësishme operacionale, përfshirë dhe sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, në rast se dëmtohet materialisht cilësia e kontrollit të brendshëm të institucionit të pagesave, si dhe pengohet Banka e Shqipërisë në monitorimin e përputhshmërisë së institucionit të pagesave me të gjitha detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.”.

6. Pas shkronjës “ç” të pikës 9 shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) të heqë ose të modifikojë asnjë nga kushtet e tjera, sipas të cilave është licencuar institucioni i pagesave.”.

7. Pikat 10 dhe 11 ndryshohen si më poshtë:

“10. Institucioni i pagesave siguron që agjentët ose degët e tij të informojnë përdoruesit e shërbimeve të pagesave se për llogari të cilit institucion veprojnë.

11. Institucionet e pagesave njoftojnë menjëherë Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim lidhur me marrëveshjet me të tretët dhe në përputhje me procedurat e parashikuara në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij neni, lidhur me agjentët, përfshirë edhe agjentët e rinj.”.

Neni 16

Kudo në nenin 22 fjala “deleguar” zëvendësohet me fjalën “transferuar”.

Neni 17

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 23

Ruajtja e të dhënave

Institucionet e pagesave i ruajnë të gjitha të dhënat e nevojshme për qëllime të këtij titulli për një periudhë të paktën 5-vjeçare, pa cenuar kërkesat e legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe ligje të tjera.”.

Neni 18

Titulli i seksionit 3 ndryshohet dhe bëhet “Autoritetet përgjegjëse dhe procesi i mbikëqyrjes”.

Neni 19

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24
Autoriteti përgjegjës

1. Banka e Shqipërisë është autoriteti përgjegjës që licencon dhe mbikëqyr institucionet e pagesave, sipas dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

2. Banka e Shqipërisë është e pavarur në ushtrimin e funksionit të vet licencues e mbikëqyrës dhe duhet të sigurojë shmangien e konflikteve të interesit.

3. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me autoritete të tjera publike vendase ose të huaja, për qëllime të ushtrimit të funksionit të saj licencues dhe mbikëqyrës.

4. Ushtrimi i funksionit mbikëqyrës, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, nuk nënkupton që Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për ushtrimin e mbikëqyrjes së veprimtarive tregtare të institucioneve të pagesave, të ndryshme nga ofrimi i shërbimeve të pagesave të listuara në aneksin 1 të këtij ligji dhe nga veprimtaritë e parashikuara në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 19 të këtij ligji.

5. Pa cenuar sa parashikohet në pikën 4 të këtij neni, Banka e Shqipërisë mund t’u kërkojë institucioneve të pagesave, që operojnë sisteme pagesash ose kryejnë veprimtaritë e parashikuara në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 19 të këtij ligji, të japin çdo informacion që është i rëndësishëm për ushtrimin e funksionit të saj mbikëqyrës.”.

Neni 20

Shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të nenit 25 ndryshohen si më poshtë:

“a) t’i kërkojë institucionit të pagesave çdo informacion të nevojshëm për të monitoruar përputhshmërinë, përfshirë edhe informacion për agjentët apo degët që ofrojnë shërbime pagese në emër të tij ose për palët e treta me të cilat ka lidhur marrëveshje për transferimin e funksioneve operacionale, duke specifikuar

qëllimin e kërkesës sipas rastit, si dhe afatin kohor në të cilin informacioni duhet të sigurohet;

b) të kryejë inspektime në vend në institucionin e pagesave, në çdo agjent apo degë që ofron shërbime pagese në emër të tij ose në çdo palë të tretë me të cilën ka lidhur marrëveshje për transferimin e funksioneve operacionale;”.

Neni 21

Në nenin 26 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2 pas fjalëve “në shkëmbimin e informacionit” shtohen fjalët “sipas përcaktimeve të nenit 26/1 të këtij ligji”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Banka e Shqipërisë mund të shkëmbejë informacion me autoritetet e tjera mbikëqyrëse vendase ose të huaja, përgjegjëse për mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave, bankat qendrore të huaja, institucionet e tjera ndërkombëtare, subjektet e tjera përgjegjëse për auditimin financiar dhe çdo person të punësuar nga këto autoritete, institucione dhe subjekte, duke respektuar parimin e reciprocitetit, të miratimit paraprak me kusht që të ruhet konfidencialiteti, sekreti profesional e të garantohet niveli i mbrojtjes së të dhënave personale. Informacioni i shkëmbyer duhet të jetë gjithmonë në funksion të detyrave specifike të autoriteteve dhe institucioneve përkatëse që marrin atë informacion.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Banka e Shqipërisë në procesin e shkëmbimit të informacionit, sipas këtij neni, respekton kërkesat e parashikuara në legjislacionin e zbatueshëm për bankat mbi shkëmbimin e informacionit dhe sekretin profesional.”.

Neni 22

Pas nenit 26 shtohen nenet 26/1, 26/2, 26/3, 26/4, 26/5, 26/6, 26/7 dhe 26/8 me këtë përmbajtje:

“Neni 26/1

Shkëmbimi i informacionit

1. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me autoritetet e shteteve të tjera anëtare, përgjegjëse për licencimin dhe mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve të pagesave, dhe, kur është e përshtatshme, me Autoritetin Bankar Evropian, Bankën Qendrore Evropiane dhe bankat qendrore të shteteve të tjera anëtare në cilësinë e tyre si autoritete monetare dhe autoritete mbikëqyrëse të sistemeve të pagesave ose të shlyerjes së titujve, sa herë që është e nevojshme për qëllimin e kryerjes së detyrave të saj.

2. Banka e Shqipërisë mund të shkëmbejë informacion që është i rëndësishëm për ushtrimin e detyrave të saj me:

a) autoritete të shteteve të tjera anëtare, përgjegjëse për licencimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave;

b) Bankën Qendrore Evropiane dhe bankat qendrore të shteteve të tjera anëtare, në cilësinë e tyre si autoritete monetare dhe autoritete mbikëqyrëse, dhe, kur është e përshtatshme, autoritete të tjera publike, përgjegjëse për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave ose të shlyerjes së titujve;

c) autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e personave përgjegjës për auditimin ligjor të llogarive të institucioneve të pagesave dhe, kur është e përshtatshme, të personave përgjegjës për auditimin ligjor të llogarive të konsoliduara që përfshijnë llogaritë e institucioneve të pagesave;

ç) autoritete të tjera përgjegjëse, sipas këtij ligji dhe legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

d) Autoritetin Bankar Evropian, në cilësinë e tij për të kontribuuar në funksionimin e qëndrueshëm dhe koherent të mekanizmave mbikëqyrës, siç parashikohet në shkronjën “a” të nenit 1(5) të rregullores (BE) 1093/2010.

3. Banka e Shqipërisë mund të shkëmbejë informacion që është i rëndësishëm për ushtrimin e detyrave të saj me autoritetet përkatëse të vendeve të treta, të parashikuara në pikën 2, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të këtij neni.

Neni 26/2

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me autoritetet përgjegjëse të shteteve anëtare

1. Kur Banka e Shqipërisë konsideron se në një çështje të caktuar bashkëpunimi ndërkufitar me autoritetet përgjegjëse të një shteti tjetër anëtar, të referuara në nenet 26/1, 26/3, 26/4, 26/5 ose 26/6 të këtij ligji, nuk është në përputhje me kushtet përkatëse, të përcaktuara në këto dispozita, mund t’ia referojë çështjen Autoritetit Bankar Evropian dhe të kërkojë ndihmën e tij në përputhje me nenin 19 të rregullores (EU) 1093/2010.

2. Banka e Shqipërisë mund të arrijë një marrëveshje me autoritetin përgjegjës të një shteti tjetër anëtar me ndërmjetësimin e Autoritetit Bankar Evropian.

3. Banka e Shqipërisë pezullon marrjen e vendimeve për çështjet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni deri në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 26/3

Ushtrimi i të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime

1. Çdo institucion pagese i licencuar nga Banka e Shqipërisë që, në kuadër të ushtrimit të së drejtës së vendosjes ose lirisë për të ofruar shërbime, kërkon të ofrojë për herë të parë shërbime pagesash në një shtet tjetër anëtar, direkt ose nëpërmjet krijimit të një dege ose përdorimit të agjentëve, njofton me shkrim për këtë Bankën e Shqipërisë dhe i paraqet informacionin e mëposhtëm:

a) emrin, adresën dhe numrin e licencës së institucionit të pagesës;

b) shtetin ose shtetet anëtare ku synon të operojë;

c) shërbimin ose shërbimet e pagesave që do të ofrojë;

ç) kur institucioni i pagesave synon të përdorë agjentët, informacionin e parashikuar në pikën 1 të nenit 21 të këtij ligji;

d) kur institucioni i pagesës synon të operojë nëpërmjet një dege, informacionin e parashikuar në shkronjat “b” dhe “d” të pikës 1 të nenit 7 të këtij ligji, në lidhje me veprimtarinë e shërbimeve të pagesave në shtetin anëtar pritës, një përshkrim të strukturës organizative të degës dhe identitetin e personave përgjegjës për administrimin e degës.

Institucioni i pagesave njofton paraprakisht Bankën e Shqipërisë në rastin kur synon të lidhë marrëveshje me të tretët (*outsourcing*) në shtetin anëtar pritës për transferimin e funksioneve operacionale të shërbimeve të pagesave.

2. Brenda një muaji nga marrja e të gjithë informacionit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni Banka e Shqipërisë e dërgon këtë informacion tek autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar pritës.

3. Brenda 3 muajve nga marrja e informacionit të referuar në pikën 1 të këtij neni Banka e Shqipërisë komunikon vendimin e saj tek autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar pritës dhe tek institucioni i pagesës.

4. Nëse vlerësimi i Bankës së Shqipërisë, veçanërisht me marrjen e informacionit nga autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar pritës në përputhje me nënparagrafin e dytë të nenit 28(2) të direktivës (BE) 2015/2366, nuk është pozitiv, Banka e Shqipërisë refuzon regjistrimin e agjentit ose degës ose mund të shfuqizojë regjistrimin nëse ai është bërë tashmë. Në rastet kur Banka e Shqipërisë nuk bie dakord me vlerësimin e autoriteteve përgjegjëse të shtetit anëtar pritës, i njofton ata për arsyet e vendimmarrjes së saj.

5. Me regjistrimin në regjistër, sipas parashikimeve të nenit 16 të këtij ligji, agjenti ose dega mund të fillojë të ushtrojë veprimtarinë e vet në shtetin anëtar pritës përkatës.

6. Institucioni i pagesave i njofton Bankës së Shqipërisë datën prej së cilës ka filluar ushtrimin e veprimtarisë nëpërmjet agjentit ose degës në shtetin anëtar pritës përkatës. Banka e Shqipërisë njofton për këtë autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar pritës.

7. Institucioni i pagesave njofton Bankën e Shqipërisë, pa vonesa të panevojshme, për çdo ndryshim në lidhje me informacionin e komunikuar sipas pikës 1 të këtij neni, përfshirë informacionin për agjentët e rinj, degët e reja apo marrëveshjet e reja me palët e treta për transferimin e funksioneve të tij në shtetet anëtare pritëse ku ai operon. Për këto ndryshime do të zbatohet procesi i parashikuar në pikat 2 deri në 6 të këtij neni.

8. Institucionet e pagesave të licencuara në një shtet tjetër anëtar mund të ofrojnë shërbime pagesash në territorin e Republikës së Shqipërisë, direkt ose nëpërmjet krijimit të një dege ose përdorimit të agjentëve, me kusht që shërbimet e pagesave të jenë të parashikuara në licencën apo autorizimin e dhënë në shtetin anëtar të origjinës.

Nëse Banka e Shqipërisë merr informacionin e parashikuar në nenin 28(2) të direktivës (BE) 2015/2366 nga autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar të origjinës, ajo e vlerëson informacionin brenda një muaji nga data e marrjes së tij. Banka e

Shqipërisë u vë në dispozicion autoriteteve përgjegjëse të shtetit anëtar të origjinës informacionin përkatës në lidhje me ofrimin e synuar të shërbimeve të pagesave nga institucioni përkatës i pagesave, direkt apo nëpërmjet krijimit të një dege ose përdorimit të agjentëve.

9. Nëse Banka e Shqipërisë dyshon se në lidhje me krijimin e degës ose përdorimin e agjentëve po kryhet ose është kryer pastrim parash ose financim i terrorizmit, në kuptim të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ose se krijimi i një dege të tillë apo përdorimi i agjentëve të tillë mund të rritë rrezikun e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, ajo njofton autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar të origjinës për çdo bazë të arsyeshme shqetësimi.

10. Në kuadër të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit midis Bankës së Shqipërisë dhe autoriteteve përgjegjëse të shtetit anëtar pritës ose të origjinës sipas parashikimeve të këtij neni, zbatohen standardet teknike, të parashikuara në rregulloren (BE) 2017/2055 për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse në lidhje me ushtrimin e së drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime të institucioneve të pagesave.

Neni 26/4

Mbikëqyrja e institucioneve të pagesave që ushtrojnë të drejtën e vendosjes dhe lirinë për të ofruar shërbime

1. Mbikëqyrja e një institucioni pagesash nga Banka e Shqipërisë, në rolin e autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar të origjinës, do të përfshijë edhe veprimtaritë e kryera nga institucioni i pagesave në një shtet tjetër anëtar nëpërmjet krijimit të një dege ose përdorimit të agjentëve për ofrimin e shërbimeve.

2. Mbikëqyrja e një institucioni pagesash që ofron shërbime pagesash nëpërmjet krijimit të një dege ose përdorimit të agjentëve në Republikën e Shqipërisë, për të cilin shteti anëtar i origjinës është një shtet tjetër anëtar, është përgjegjësi e autoriteteve përgjegjëse të shtetit anëtar të origjinës, pa cenuar dispozitat e këtij ligji që parashikojnë përgjegjësinë e Bankës së Shqipërisë në rolin e saj si autoritet përgjegjës i shtetit anëtar pritës.

3. Banka e Shqipërisë, në rolin e autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar të origjinës, bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar pritës për të kryer kontrollet dhe për të ndërmarrë hapat e nevojshëm të parashikuar në këtë titull dhe në titujt III dhe IV të këtij ligji, në lidhje me agjentët ose degën e një institucioni pagesash të vendosur në territorin e një shteti tjetër anëtar.

4. Për qëllime të bashkëpunimit, në përputhje me pikën 3 të këtij neni, Banka e Shqipërisë, në rolin e autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar të origjinës, njofton autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar pritës para se të kryejë një inspektim në vend në territorin e këtij të fundit. Banka e Shqipërisë ka gjithashtu të drejtën t'u kërkojë dhe mund t'ua delegojë autoriteteve përgjegjëse të shtetit anëtar pritës kryerjen e një inspektimi të tillë në vend.

5. Në rastet kur një institucion pagesash ofron shërbime pagesash direkt ose nëpërmjet krijimit të një dege ose përdorimit të agjentëve në Republikën e Shqipërisë, për të cilin shteti anëtar i origjinës është një shtet tjetër anëtar, Banka e Shqipërisë, në rolin e saj si autoritet përgjegjës i shtetit anëtar pritës, bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar të origjinës për t'u mundësuar atyre kryerjen e kontrolleve dhe marrjen e masave të nevojshme, të parashikuara në nenin 23 të Direktivës (BE) 2015/2366, në lidhje me agjentët ose degët.

6. Për qëllime të bashkëpunimit, në përputhje me pikën 5 të këtij neni, autoriteti përgjegjës i shtetit anëtar të origjinës, pasi njofton Bankën e Shqipërisë, mund të kryejë vetë ose nëpërmjet personave që ai cakton për këtë qëllim një inspektim në vend në Republikën e Shqipërisë. Autoriteti përgjegjës i shtetit anëtar të origjinës gjithashtu mund t'i kërkojë Bankës së Shqipërisë të kryejë një inspektim të tillë në vend, në emër të tij.

7. Institucionet e pagesave që ofrojnë shërbime pagesash nëpërmjet agjentëve ose degëve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për të cilat shteti anëtar i origjinës është një shtet tjetër anëtar, raportojnë periodikisht në Bankën e Shqipërisë, në rolin e autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar pritës, për veprimtaritë e kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas formatit dhe frekuencës së parashikuar për këtë qëllim në rregulloren e deleguar të Komisionit (BE) 2021/1722.

8. Raportimet e parashikuara në pikën 7 të këtij neni kërkohen për qëllime informimi ose statistikore dhe, për sa kohë që agjentët dhe degët ushtrojnë veprimtarinë e shërbimeve të pagesave sipas së drejtës së vendosjes, për të monitoruar përputhshmërinë me dispozitat e titujve III dhe IV të këtij ligji. Këta agjentë dhe degë do t'u nënshtrohen kërkesave të sekretit profesional, të parashikuara në nenin 26 të këtij ligji.

9. Banka e Shqipërisë, në rolin e autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar të origjinës, shkëmben me autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar pritës, ku një institucion pagese ofron shërbime pagesash nëpërmjet krijimit të një dege ose përdorimit të agjentëve, të gjitha informacionet thelbësore dhe/ose relevante, veçanërisht në rastin e shkeljeve ose shkeljeve të dyshuara nga një agjent ose një degë, përfshirë dhe rastet kur shkelje të tilla kanë ndodhur në kontekstin e ushtrimit të lirisë për të ofruar shërbime. Në këtë aspekt, Banka e Shqipërisë do të komunikojë, me kërkesë të autoriteteve të tjera përgjegjëse, të gjitha informacionet relevante dhe, me iniciativën e saj, të gjitha informacionet thelbësore, duke përfshirë edhe përputhshmërinë e institucionit të pagesave me kushtet sipas nenit 13, pika 2/1, të këtij ligji.

10. Banka e Shqipërisë, në rolin e autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar pritës, për institucionet e pagesave që ofrojnë shërbime pagesash nëpërmjet agjentëve ose degëve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për të cilat shteti anëtar i origjinës është një shtet tjetër anëtar, shkëmben me autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar të origjinës të gjitha informacionet thelbësore dhe/ose relevante, veçanërisht në rastin e shkeljeve ose shkeljeve të dyshuara nga një agjent ose një degë, përfshirë edhe rastet kur shkelje të tilla kanë ndodhur në kontekstin e ushtrimit të lirisë për të ofruar shërbime. Në këtë aspekt, Banka e Shqipërisë do të komunikojë,

me iniciativën e saj, të gjitha informacionet thelbësore dhe, me kërkesë të autoriteteve të tjera përgjegjëse, informacionet relevante, duke përfshirë edhe përputhshmërinë e institucionit të pagesave me kushtet sipas nenit 13, pika 2/1, të këtij ligji.

11. Institucionet e pagesave që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet agjentëve, sipas të drejtës së vendosjes, zyra qendrore e të cilave ndodhet në një shtet tjetër anëtar, duhet të caktojnë një pikë qendrore kontakti në territorin e Republikës së Shqipërisë, për të siguruar komunikim dhe raportim të përshtatshëm të informacionit për përputhshmërinë me titujt III dhe IV të këtij ligji, pa cenuar asnjë dispozitë për kërkesat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe për të lehtësuar mbikëqyrjen nga autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar të origjinës dhe nga Banka e Shqipërisë, në rolin e autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar pritës. Pika qendrore e kontaktit paraqet pranë Bankës së Shqipërisë dhe autoriteteve përgjegjëse të shtetit anëtar të origjinës dokumentet dhe informacionet, sipas kërkesës së këtyre autoriteteve, për qëllime të ushtrimit të funksionit të tyre mbikëqyrës.

12. Kërkesat për përcaktimin e rrethanave, kur caktimi i një pike qendrore kontakti është i përshtatshëm, si dhe funksionet e këtyre pikave qendrore të kontaktit, në përputhje me pikën 11 të këtij neni, parashikohen në rregulloren e deleguar të Komisionit (BE) 2020/1423.

13. Banka e Shqipërisë zbaton kërkesat e parashikuara në rregulloren e deleguar të Komisionit (BE) 2021/1722 për bashkëpunimin dhe për shkëmbimin e informacionit me autoritete përgjegjëse të shteteve anëtare të origjinës ose të shteteve anëtare pritëse, në përputhje me këtë titull dhe për të monitoruar përputhshmërinë me dispozitat e titujve III dhe IV të këtij ligji, për të siguruar mbikëqyrje të qëndrueshme dhe efikase të institucioneve të pagesave që ushtrojnë ofrimin e shërbimeve të pagesave në baza ndërkufitare.

Neni 26/5

Masat në rastet e mospërputhshmërisë me kërkesat e këtij ligji, përfshirë edhe masat parandaluese

1. Pa cenuar përgjegjësitë e autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar të origjinës, në rastet kur Banka e Shqipërisë, në rolin e autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar pritës, konstaton që institucioni i pagesave që ofron shërbime pagesash në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet agjentëve ose degëve nuk i përmbush kërkesat e këtij titulli ose titujve III dhe IV të këtij ligji, informon pa vonesë autoritetin përgjegjës të shtetit anëtar të origjinës.

2. Në një situatë emergjente, kur është e nevojshme të ndërmerren veprime të menjëhershme për të adresuar një kërcënim serioz ndaj interesave kolektive të përdoruesve të shërbimeve të pagesave në Republikën e Shqipërisë, Banka e Shqipërisë, paralelisht me bashkëpunimin ndërkufitar midis autoriteteve përgjegjëse dhe masave të pritshme që mund të merren nga autoriteti përgjegjës i shtetit anëtar të origjinës në përputhje me nenin 29 të direktivës (BE) 2015/2366,

mund të marrë masa parandaluese dhe/ose të vendosë sanksione të përcaktuara në këtë ligj.

3. Masat parandaluese dhe/ose sanksionet e vendosura sipas pikës 2 të këtij neni duhet të jenë të përshtatshme dhe proporcionale me qëllimin e tyre për të mbrojtur nga një kërcënim serioz interesat kolektive të përdoruesve të shërbimeve të pagesave në Republikën e Shqipërisë. Në çdo rast, masat nuk mund të rezultojnë në një trajtim preferencial të përdoruesve të shërbimeve të pagesave të një institucioni pagesash në Republikën e Shqipërisë krahasuar me trajtimin ndaj përdoruesve të shërbimeve të pagesave të këtij institucioni pagesash në shtetet e tjera anëtare. Këto masa duhet të jenë të përkohshme dhe të ndërpriten kur kërcënimet serioze të identifikuara adresohen, duke përfshirë edhe nëpërmjet ndihmës ose bashkëpunimit me autoritetet përgjegjëse të shtetit tjetër anëtar të origjinës ose me Autoritetin Bankar Evropian, siç parashikohet në nenin 26/2, pika 1, të këtij ligji.

4. Në rastet e situatave emergjente Banka e Shqipërisë, në rolin e autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar pritës, informon paraprakisht autoritetet përgjegjëse të shtetit anëtar të origjinës dhe ato të çdo shteti tjetër anëtar të interesuar, Komisionin Evropian dhe Autoritetin Bankar Evropian, pa vonesa të panevojshme për masat dhe/ose sanksionet e vendosura sipas pikës 2 të këtij neni dhe arsyet përkatëse për vendosjen e tyre.

5. Në rastet kur Banka e Shqipërisë, në rolin e autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar të origjinës, njoftohet nga ana e autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar pritës sipas nënparagrafit të dytë të nenit 30 (1) të direktivës (BE) 2015/2366 për mospërmbushjen e kërkesave ligjore nga ana e institucioneve të pagesave që ofrojnë shërbime pagesash nëpërmjet agjentëve ose degëve në atë shtet, e vlerëson informacionin e marrë dhe pa vonesë merr të gjitha masat e duhura për të siguruar që institucioni i pagesave në fjalë i jep fund situatës së tij të parregullt. Këto masa i komunikohen pa vonesa autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar pritës dhe autoriteteve përgjegjëse të çdo shteti tjetër anëtar të interesuar.

Neni 26/6

Arsyetimi dhe njoftimi i masës së marrë nga Banka e Shqipërisë

1. Banka e Shqipërisë njofton institucionin përkatës të pagesave për çdo masë të marrë ndaj tij dhe arsyet përkatëse, në zbatim të neneve 25, 26/3, 26/4 ose 26/5 të këtij ligji, që përfshin vendosjen e sanksioneve ose kufizime në ushtrimin e lirisë për të ofruar shërbime ose të drejtës së vendosjes.

2. Dispozitat e neneve 26/3, 26/4 dhe 26/5 të këtij ligji zbatohen pa cenuar të drejtën e Bankës së Shqipërisë për të mbikëqyrur ose monitoruar përputhshmërinë me kërkesat e legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe të kërkesave për informacionin që shoqëron transfertat e fondeve.

Neni 26/7

Hapja e degës së institucionit të pagesave me zyrë qendrore në një vend të tretë

1. Institucioni i pagesave me zyrë qendrore në një vend të tretë që kërkon të hapë një degë në Republikën e Shqipërisë u nënshtrohet kërkesave dhe rregullave të njëjta, të parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, për licencimin e institucioneve të pagesave.

2. Për qëllime të zbatimit të pikës 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë vlerëson plotësimin e kushteve të kërkuara për licencim nga institucioni i pagesave që kërkon të hapë degën në Republikën e Shqipërisë.

3. Dega e institucionit të pagesave me zyrë qendrore në një vend të tretë duhet të disponojë kapital të dhuruar të mjaftueshëm, të paktën sa shuma e kapitalit të kërkuar për licencimin e institucioneve të pagesave, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

4. Kërkesat e parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij për licencimin e institucioneve të pagesave, në lidhje me reputacionin dhe përvojën e administratorëve dhe drejtuesve të institucionit të pagesave, duhet të plotësohen edhe nga personat përgjegjës për drejtimin e degës së institucionit të pagesave.

5. Institucioni i pagesave me zyrë qendrore në një vend të tretë që kërkon të hapë një degë në Republikën e Shqipërisë paraqet pranë Bankës së Shqipërisë edhe miratimin e autoritetit përgjegjës të vendit të tretë për hapjen e degës në Republikën e Shqipërisë, si dhe konfirmimin e tij që ky institucion i pagesave ka një licencë aktive në vendin e tretë dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me kuadrin ligjor vendas.

6. Banka e Shqipërisë njofton Komisionin Evropian për të gjitha licencimet e degëve të institucioneve të pagesave që e kanë zyrën e tyre qendrore në vende të treta.

Neni 26/8

Hapja e degës së institucionit të pagesave në një vend të tretë

1. Një institucion pagesash i licencuar nga Banka e Shqipërisë mund të ofrojë shërbime pagesash në një vend të tretë nëpërmjet një dege. Për këtë qëllim, institucioni i pagesave merr miratimin e Bankës së Shqipërisë.

2. Për qëllime të hapjes së një dege në një vend të tretë, institucioni i pagesave i paraqet Bankës së Shqipërisë një aplikim për dhënien e miratimit, të shoqëruar me të dhënat dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe adresën e degës;

b) përshkrimin e strukturës organizative të degës;

c) planin e biznesit të degës për 3 vjetët e parë të veprimtarisë dhe përshkrimin e shërbimeve të pagesave që synon të ofrojë nëpërmjet degës;

ç) të dhëna për personat që do të drejtojnë veprimtarinë e degës dhe për personat që do të drejtojnë drejtpërdrejt ofrimin e shërbimeve të pagesave në degë, të shoqëruara me të dhëna dhe evidenca për reputacion të mirë profesional dhe

kualifikime e përvojë të përshtatshme profesionale, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe akteve nënligjore përkatëse.

3. Banka e Shqipërisë mund të përcaktojë me akt nënligjor kërkesa shtesë, përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni.

4. Nëse informacioni i paraqitur sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni nuk është i plotë, Banka e Shqipërisë brenda një muaji nga marrja e aplikimit njofton institucionin e pagesave për plotësimin e informacionit të nevojshëm. Në rast të kërkesës për informacion shtesë, data e pranimit të aplikimit llogaritet nga dita e paraqitjes së informacionit të plotë.

5. Banka e Shqipërisë vendos mbi aplikimin e paraqitur nga institucioni i pagesave për hapjen e degës në një vend të tretë brenda 3 muajve nga data e pranimit të aplikimit të plotë.

6. Banka e Shqipërisë e refuzon kërkesën për hapjen e një dege në një vend të tretë nëse, bazuar në informacionin në dispozicion, vlerëson se:

a) institucioni i pagesave që synon të hapë degën nuk ka strukturë të përshtatshme organizative dhe teknike ose një situatë financiare që i mundëson ofrimin e shërbimeve të planifikuara në vendin e tretë;

b) duke konsideruar kuadrin ligjor e rregullativ të vendit të tretë ose praktikat për zbatimin e tij, ka dyshime që ushtrimi i mbikëqyrjes në përputhje me dispozitat e këtij ligji vështirësohet ose pengohet; ose

c) institucioni i pagesave nëpërmjet hapjes së degës në vendin e tretë përpiqet të shmangë kërkesat e zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

7. Në rastet kur një institucion pagesash që ka marrë miratimin e Bankës së Shqipërisë për hapjen e një dege në një vend të tretë synon të hapë degë të tjera në atë vend, ai njofton për këtë Bankën e Shqipërisë. Dispozitat e pikave 2 deri në 6 të këtij neni nuk zbatohen në këto raste.

8. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor kushtet dhe procedurën e dhënies së miratimit ose refuzimit, të parashikuar në këtë nen.

9. Në rastet kur një institucion pagesash që ka marrë miratimin e Bankës së Shqipërisë për hapjen e një dege në një vend të tretë synon të ndryshojë ndonjë nga informacionet e parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, ai njofton për këtë Bankën e Shqipërisë të paktën një muaj përpara se ta bëjë këtë ndryshim.

10. Banka e Shqipërisë mund të shfuqizojë miratimin për hapjen e një dege në një vend të tretë nga një institucion pagesash:

a) kur konstatohet se institucioni i pagesave nuk i përmbush më kërkesat organizative e teknike në lidhje me shërbimet që ofron;

b) kur institucioni i pagesave nuk respekton kuadrin ligjor e rregullativ të vendit pritës gjatë ushtrimit të veprimtarisë së degës; ose

c) kur nga shpërndarja territoriale e ofrimit të shërbimeve është e qartë se institucioni i pagesave në këtë mënyrë përpiqet të shmangë kërkesat e zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

11. Banka e Shqipërisë shfuqizon miratimin për hapjen e një dege në një vend të tretë nga një institucion pagesash:

a) kur autoriteti përgjegjës i vendit pritës i ka ndaluar institucionit të pagesave ofrimin e shërbimeve në territorin e tij;

b) kur dega nuk fillon veprimtarinë brenda 6 gjashtë muajve nga marrja e miratimit;

c) kur dega nuk ka ushtruar veprimtaritë e përfshira në licencë për më shumë se 6 muaj; ose

ç) kur institucioni i pagesave ka marrë miratimin për hapjen e degës mbi bazën e të dhënave të rreme ose të pasakta, të cilat kanë qenë të rëndësishme për dhënien e miratimit.

12. Banka e Shqipërisë ushtron funksionin e saj mbikëqyrës edhe për degët e institucioneve të pagesave të licencuara prej saj që ofrojnë shërbime pagesash në një vend të tretë.

13. Për qëllime të ushtrimit të funksionit mbikëqyrës të parashikuar në pikën 12 të këtij neni, Banka e Shqipërisë bashkëpunon edhe me autoritetet mbikëqyrëse të vendit të tretë, sipas parashikimeve të nenit 26/4 të këtij ligji.".

Neni 23

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 27

Kushtet për përjashtimin e institucioneve të pagesave

1. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të përjashtojë personat fizikë ose juridikë që ofrojnë shërbimet e pagesave të listuara në pikat 1 deri në 6 të aneksit 1 të këtij ligji nga zbatimi i të gjitha ose të një pjese të kërkesave dhe kushteve të përcaktuara në seksionet 1, 2 dhe 3 të kreut I të titullit II të këtij ligji, me përjashtim të neneve 16, 24, 26, 96 e 97 dhe 26/1 të këtij ligji, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) mesatarja mujore e shumës totale të transaksioneve të pagesave të kryera gjatë 12 muajve paraardhës nga personi në fjalë, duke përfshirë edhe agjentët për të cilët merr përgjegjësi të plotë, nuk tejkalon limitin e vendosur nga Banka e Shqipërisë me akt nënligjor, që në çdo rast nuk tejkalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 3 milionë euro. Kjo kërkesë do të vlerësohet bazuar në shumën totale të transaksioneve të pagesave të parashikuara në planin e biznesit të personit, përveç rastit kur Banka e Shqipërisë kërkon një përshtatje në këtë plan biznesi; dhe

b) asnjë nga personat përgjegjës për administrimin apo ushtrimin e veprimtarisë të mos jenë dënuar për vepra penale të lidhura me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit ose në fushën financiare.

2. Çdo person fizik ose juridik i regjistruar në përputhje me pikën 1 të këtij neni duhet të ketë zyrën e tij qendrore ose vendin e rezidencës në Republikën e Shqipërisë, ku edhe ushtron veprimtarinë e tij.

3. Personat, sipas pikës 1 të këtij neni, konsiderohen dhe trajtohen si institucione pagesash, me përjashtim të pikës 9 të nenit 13 dhe neneve 26/3, 26/4 dhe 26/5, të cilat nuk zbatohen për këta persona.

4. Çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në përputhje me pikën 1 të këtij neni, mund të kryejë vetëm disa nga veprimtaritë e parashikuara në nenin 19 të këtij ligji, sipas përcaktimeve, rast pas rasti, të Bankës së Shqipërisë.

5. Personat, sipas pikës 1 të këtij neni, njoftojnë Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim të situatës së tyre, që lidhet me kushtet e specifikuara në atë pikë. Këta persona, në rast se nuk përmbushin më kushtet e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 4 të këtij neni, i paraqesin Bankës së Shqipërisë kërkesën për licencim brenda 30 ditëve, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 13 të këtij ligji.

6. Pikat 1 deri në 5 të këtij neni nuk zbatohen në lidhje me legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

7. Banka e Shqipërisë informon Komisionin Evropian për numrin e personave fizikë dhe juridikë të përjashtuar sipas këtij neni dhe në baza vjetore për vlerën totale të transaksioneve të pagesave të ekzekutuara deri më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik, siç parashikohet në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni.”.

Neni 24

Pas kreut I të titullit II shtohet kreu II, i cili përmban nenet 28/1, 28/2, 28/3, 28/4, 28/5, 28/6, 28/7, 28/8, 28/9, 28/10, 28/11 dhe 28/12 me këtë përmbajtje:

“KREU II
INSTITUCIONET E PARASË ELEKTRONIKE

Seksioni 1

Kërkesat për krijimin, ushtrimin e veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të parasë elektronike

Neni 28/1
Rregulla të përgjithshme

1. Pa cenuar parashikimet e këtij kreu, dispozitat e nenit 7, të neneve 13 deri në 18, të nenit 21, pika 4/1 dhe pikat 6, 7, 8 dhe 9, të neneve 22 deri në 26/6, si dhe të neneve 96 dhe 97 të këtij ligji, përfshirë edhe aktet e deleguara në referencë të nenit 16, pika 8, nenit 26/3, pika 10, dhe nenit 26/4, pikat 7, 12 dhe 13, do të zbatohen me ndryshimet përkatëse (*mutatis mutandis*) edhe për institucionet e parasë elektronike.

2. Çdo person fizik ose juridik, i cili ka marrë një vendim për të blerë ose për të shitur një pjesëmarrje influencuese të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në kuptim të këtij ligji, në një institucion të parasë elektronike, ose për të rritur, ose për të reduktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë një pjesëmarrje influencuese, si rezultat i të cilit pjesa e kapitalit ose e të drejtave të votës të zotëruara prej tij arrin, tejkalon ose bie nën 20%, 30% ose 50%, ose që institucioni i parasë elektronike të bëhet shoqëri e kontrolluar prej tij, ose që institucioni i

parasë elektronike të mos jetë më shoqëri e kontrolluar prej tij, informon paraprakisht me shkrim për këtë qëllim Bankën e Shqipërisë.

3. Personat fizikë ose juridikë, sipas pikës 2 të këtij neni, i paraqesin Bankës së Shqipërisë masën e synuar të pjesëmarrjes, si dhe dokumentacionin dhe informacionin përkatës, sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin e zbatueshëm për bankat, në lidhje me zotërimin e pjesëmarrjes influencuese në një institucion krediti dhe në aktet nënligjore përkatëse të dala në zbatim të atyre kërkesave.

4. Banka e Shqipërisë, kur gjykon se pjesëmarrja e ushtruar sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni mund të dëmtojë administrimin e kujdesshëm e të qëndrueshëm të institucionit të parasë elektronike, kundërshton ndryshimin e pjesëmarrjes influencuese brenda 3 muajve nga data e plotësimit të kërkesave të përcaktuara në këtë nen ose merr masa të tjera të përshtatshme për të përfunduar këtë situatë. Masat mund të përfshijnë urdhra, sanksione ndaj administratorëve ose personave përgjegjës për administrimin e subjektit ose pezullimin e ushtrimit të të drejtave të votës, që lidhen me aksionet ose kuotat e mbajtura nga aksionarët ose ortakët e institucionit të parasë elektronike në fjalë.

Masa të ngjashme zbatohen edhe për personat fizikë ose juridikë që nuk përmbushin detyrimin për të dhënë informacion paraprak, siç përcaktohet në pikën 2 të këtij neni.

5. Nëse pjesëmarrja influencuese zotërohet pavarësisht kundërshtimit të Bankës së Shqipërisë, sipas pikës 4 të këtij neni, përveç çdo sanksioni tjetër që mund të vendoset, Banka e Shqipërisë urdhëron pezullimin e ushtrimit të të drejtave përkatëse të votës, pavlefshmërinë e votave të dhëna ose mundësinë e anulimit të këtyre votave.

Çdo pjesëmarrje që fitohet në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji është absolutisht e pavlefshme.

6. Banka e Shqipërisë mund të lejojë moszbatimin e të gjitha ose të një pjese të detyrimeve, sipas pikave 2 deri në 5 të këtij neni, në lidhje me institucionet e parasë elektronike që kryejnë një ose më shumë nga aktivitetet e listuara në nenin 28/4, pika 1, shkronja “d”, të këtij ligji.

7. Institucionet e parasë elektronike mund të shpërndajnë dhe të ripaguajnë fondet e parasë elektronike nëpërmjet personave fizikë ose juridikë (agjentë) të cilët veprojnë në emër dhe për llogari të institucionit të parasë elektronike.

8. Nëse institucioni i parasë elektronike synon të shpërndajë para elektronike në një shtet tjetër anëtar, duke angazhuar një person fizik ose juridik, nenet 26/2 deri në 26/6 të këtij ligji, me përjashtim të nenit 26/4, pikat 11 dhe 12, të këtij ligji, përfshirë edhe aktet e deleguara në referencë të nenit 16, pika 8, nenit 26/3, pika 10, dhe nenit 26/4, pikat 7, 12 dhe 13, do të zbatohen me ndryshimet përkatëse (mutatis mutandis) edhe për institucionet e parasë elektronike.

9. Pavarësisht nga sa parashikohet në pikat 7 dhe 8 të këtij neni, institucionet e parasë elektronike nuk mund të emetojnë para elektronike nëpërmjet agjentëve. Institucionet e parasë elektronike lejohen të ofrojnë shërbimet e pagesave të

parashikuara në nenin 28/4, pika 1, shkronja “a”, të këtij ligji, nëpërmjet agjentëve, vetëm nëse përmbushen kushtet e parashikuara në nenin 21 të këtij ligji.

Neni 28/2
Kapitali fillestar

1. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor shumën e kapitalit fillestar minimal të kërkuar për t’u licencuar si institucion i parasë elektronike dhe përcakton elementet përbërëse të tij.

2. Kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, për t’u licencuar si institucion i parasë elektronike, subjekti duhet të plotësojë shumën minimale të kapitalit fillestar, të paktën sa vlera ekuivalente në lekë e shumës 350 000 euro.

3. Deri në anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian subjektet që kërkojnë të licencohen si institucione të parasë elektronike plotësojnë shumën minimale të kapitalit fillestar, të parashikuar në aktin nënligjor përkatës të Bankës së Shqipërisë.

Neni 28/3
Fondet e veta

1. Fondet e veta të institucionit të parasë elektronike nuk mund të bien nën shumën e kapitalit fillestar minimal të parashikuar në nenin 28/2 të këtij ligji ose nën vlerën e fondeve të veta, të llogaritur në përputhje me këtë nen, cilado qoftë më e lartë.

2. Kërkesa për fondet e veta e institucionit të parasë elektronike, për veprimtaritë e parashikuara në nenin 28/4, pika 1, shkronja “a”, të këtij ligji, të cilat nuk janë të lidhura me emetimin e parasë elektronike, do të përllogaritet në përputhje me një nga 3 metodat (A, B ose C), të parashikuara në nenin 11 të këtij ligji, dhe sipas metodës së përcaktuar në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

3. Institucionet e parasë elektronike, në lidhje me veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike, përllogaritin kërkesën për fondet e veta sipas metodës D, siç parashikohet në pikën 5 të këtij neni.

4. Institucionet e parasë elektronike duhet të mbajnë në çdo kohë fonde të veta që janë të paktën të barabarta me shumën e kërkesave për fondet e veta të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

5. Metoda D:

Vlera e fondeve të veta për institucionin e parasë elektronike që ushtron vetëm veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike do të jetë në çdo kohë të paktën sa 2% e tepricës mesatare të parasë elektronike.

6. Nëse një institucion i parasë elektronike kryen ndonjë nga veprimtaritë e parashikuara në nenin 28/4, pika 1, shkronja “a”, të këtij ligji, që nuk lidhen me emetimin e parasë elektronike, ose ndonjë nga veprimtaritë e parashikuara në nenin 28/4, pika 1, shkronjat “b” deri në “d”, të këtij ligji dhe teprica e parasë elektronike nuk dihet paraprakisht, Banka e Shqipërisë lejon që ky institucion i

parasë elektronike të llogarisë kërkesën për fondet e veta, në bazë të një pjese përfaqësuese që supozohet se do të përdoret për emetimin e parasë elektronike, me kusht që një pjesë e tillë përfaqësuese të mund të vlerësohet në mënyrë të arsyeshme në bazë të të dhënave historike dhe të përmbushë kërkesat e Bankës së Shqipërisë. Kur institucioni i parasë elektronike nuk ka mbushur afatin e përcaktuar në kuadrin nënligjor të Bankës së Shqipërisë në ushtrimin e aktivitetit të tij, përllogaritja e kërkesës për fondet e veta do të kryhet në bazën e parashikimit të tepricës së parasë elektronike, siç parashikohet në planin e biznesit, duke konsideruar edhe rishikimet e propozuara nga Banka e Shqipërisë në këtë plan biznesi (nëse është e aplikueshme).

7. Banka e Shqipërisë, bazuar në një vlerësim të proceseve të administrimit të rrezikut, bazës së të dhënave të humbjeve dhe të mekanizmave të kontrollit të brendshëm të institucionit të parasë elektronike, mund t'i kërkojë institucionit të parasë elektronike që të mbajë një shumë të fondeve të veta deri në 20% më të lartë se vlera e llogaritur nga aplikimi i metodës përkatëse të përcaktuar në pikat 2 deri në 4 të këtij neni ose ta lejojë institucionin e parasë elektronike që të mbajë një shumë të fondeve të veta deri në 20% më të ulët se vlera e llogaritur nga aplikimi i metodës përkatëse të përcaktuar në pikat 2 deri në 4 të këtij neni.

8. Për qëllime të zbatimit të pikës 7 të këtij neni, Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor kriteret dhe kërkesat që duhet të plotësohen nga institucioni i parasë elektronike, për ta lejuar këtë të fundit që të mbajë një shumë të fondeve të veta deri në 20% më të ulët se vlera e llogaritur nga aplikimi i metodës përkatëse, të përcaktuar në pikat 2 deri në 4 të këtij neni.

9. Përdorimi i shumëfishtë i elementeve të kualifikuara si fonde të veta është i ndaluar në rastet kur institucioni i parasë elektronike i përket të njëjtit grup me një institucion tjetër të parasë elektronike, institucion pagesash, institucion krediti, shoqëri komisionere, shoqëri administruese, shoqëri sigurimesh ose risigurimesh. Ky ndalim zbatohet edhe në rastet kur institucioni i parasë elektronike ushtron veprimtari të tjera, të ndryshme nga emetimi i parasë elektronike. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të përcaktojë masat e nevojshme që duhet të merren nga institucioni i parasë elektronike për të parandaluar përdorimin e shumëfishtë të elementeve të kualifikuara si fonde të veta.

10. Banka e Shqipërisë mund të vendosë të përjashtojë nga zbatimi i kërkesave të pikave 2 deri në 5 të këtij neni një institucion të parasë elektronike që është pjesë e mbikëqyrjes së konsoliduar të një institucioni krediti mëmë, të licencuar nga Banka e Shqipërisë sipas legjislacionit të zbatueshëm për bankat, në rast se plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 7 të rregullores 575/2013/BE, të cilat garantojnë shpërndarjen e mjaftueshme të kapitalit midis institucionit mëmë dhe institucionit të parasë elektronike.

Neni 28/4

Veprimtaritë e tjera

1. Institucionet e parasë elektronike, përveç emetimit të parasë elektronike, mund të kryejnë një ose disa nga veprimtaritë e mëposhtme:

a) ofrimin e shërbimeve të pagesave të listuara në aneksin 1 të këtij ligji;

b) dhënien e kredive lidhur me shërbimet e pagesave të parashikuara në pikat 4 ose 5 të aneksit 1 të këtij ligji, nëse plotësohen kushtet e parashikuara në pikat 4 dhe 6 të nenit 19 të këtij ligji;

c) ofrimin e shërbimeve operacionale dhe shërbimeve ndihmëse të lidhura ngushtë, në funksion të emetimit të parasë elektronike ose të ofrimit të shërbimeve të pagesave, të parashikuara në shkronjën "a" të kësaj pike;

ç) operimin e sistemeve të pagesave, pa cenuar parashikimet e nenit 29 të këtij ligji;

d) veprimtari tregtare të ndryshme nga ato të emetimit të parasë elektronike, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

2. Kreditë e parashikuara në shkronjën "b" të pikës 1 të këtij neni do të jepen nga fondet e vetë institucionit të parasë elektronike dhe jo nga fondet e marra në këmbim të emetimit të parasë elektronike dhe të mbajtura në përputhje me pikën 1 të nenit 28/5 të këtij ligji.

3. Institucioneve të parasë elektronike nuk u lejohet të ushtrojnë veprimtarinë e pranimit të depozitave ose të fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku, sipas përcaktimit në legjislacionin e zbatueshëm për bankat.

4. Çdo fond i marrë nga institucionet e parasë elektronike nga mbajtësi i parasë elektronike duhet të shkëmbehet me para elektronike pa vonesë. Fonde të tilla nuk përbëjnë depozitë ose fonde të tjera të ripagueshme nga publiku, sipas përcaktimit në legjislacionin e zbatueshëm për bankat.

5. Për fondet e marra nga institucioni i parasë elektronike, si rrjedhojë e ushtrimit të veprimtarive, sipas shkronjës "a" të pikës 1 të këtij neni, që nuk lidhen me veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike, do të zbatohen të njëjtat kërkesa të parashikuara në pikat 2, 3 dhe 5 të nenit 19 të këtij ligji.

Neni 28/5

Kërkesat për mbrojtjen e fondeve

1. Institucionet e parasë elektronike mbrojnë fondet e marra në këmbim të parasë elektronike të emetuar, në përputhje me kërkesat e nenit 12 të këtij ligji. Fondet e marra në formën e pagesës me instrument pagese nuk është e nevojshme të mbrohen derisa ato të kreditohen në llogarinë e pagesave të institucionit të parasë elektronike ose derisa të vihen të dispozicion të institucionit të parasë elektronike, në përputhje me kërkesat për kohën e ekzekutimit, të përcaktuar në këtë ligj, aty ku është e aplikueshme. Në çdo rast, këto fonde do të mbrohen jo më vonë se 5 ditë pune pas emetimit të parasë elektronike.

2. Për qëllime të zbatimit të pikës 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor llojet e aktiveve që do të konsiderohen si aktive të sigurta, likuide me rrezik të ulët.

3. Banka e Shqipërisë, në rrethana të jashtëzakonshme dhe me arsyetim të justifikuar dhe të mjaftueshëm, mund të përcaktojë se cilat nga aktivet e parashikuara në aktet nënligjore nuk përbëjnë aktive të sigurta dhe me rrezik të ulët për qëllimet e pikës 1 të këtij neni. Ky përcaktim do të bazohet në vlerësimin e sigurisë, maturitetit, vlerës ose ndonjë elementi tjetër rreziku.

4. Institucionet e parasë elektronike zbatojnë kërkesat e nenit 12 të këtij ligji edhe për veprimtaritë e parashikuara në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 28/4 të këtij ligji, që nuk lidhen me emetimin e parasë elektronike.

5. Për qëllime të zbatimit të pikës 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë mund të përcaktojë se cila nga metodat e parashikuara në nenin 12 të këtij ligji do të përdoret nga institucionet e parasë elektronike për të mbrojtur fondet.

6. Institucionet e parasë elektronike informojnë paraprakisht Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim të rëndësishëm në metodën e përdorur dhe masat e ndërmarra prej tyre, për mbrojtjen e fondeve të pranuara në këmbim të emetimit të parasë elektronike.

7. Fondet e marra në këmbim të emetimit të parasë elektronike, pavarësisht mënyrës së zgjedhur për mbrojtjen e fondeve, në asnjë rast nuk mund të bllokohen, të jenë objekt i pretendimeve të çdo lloj kreditori të institucionit të parasë elektronike apo t'i nënshtrohen ekzekutimit të detyrueshëm të institucionit. Në rast falimentimi të institucionit të parasë elektronike, këto fonde nuk bëjnë pjesë në masën e falimentit dhe u shpërndahen mbajtësve të parasë elektronike në mënyrë proporcionale.

Neni 28/6

Hapja e degës së institucionit të parasë elektronike me zyrë qendrore në një vend të tretë

1. Institucioni i parasë elektronike me zyrë qendrore në një vend të tretë që kërkon të hapë një degë në Republikën e Shqipërisë u nënshtrohet kërkesave dhe rregullave të njëjta, të parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij për licencimin e institucioneve të parasë elektronike.

2. Për qëllime të zbatimit të pikës 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë vlerëson plotësimin e kushteve të kërkuara për licencim nga institucioni i parasë elektronike që kërkon të hapë degën në Republikën e Shqipërisë.

3. Dega e institucionit të parasë elektronike me zyrë qendrore në një vend të tretë duhet të disponojë kapital të dhuruar të mjaftueshëm, të paktën sa shuma e kapitalit të kërkuar për licencimin e institucioneve të parasë elektronike, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

4. Kërkesat e parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij për licencimin e institucioneve të parasë elektronike, në lidhje me reputacionin dhe përvojën e administratorëve dhe drejtuesve të institucionit të parasë elektronike, duhet të plotësohen edhe nga personat përgjegjës për drejtimin e degës së institucionit të parasë elektronike.

5. Institucioni i parasë elektronike me zyrë qendrore në një vend të tretë që kërkon të hapë një degë në Republikën e Shqipërisë paraqet pranë Bankës së Shqipërisë edhe miratimin e autoritetit përgjegjës të vendit të tretë për hapjen e degës në Republikën e Shqipërisë, si dhe konfirmimin e tij që ky institucion i parasë elektronike ka një licencë aktive në vendin e tretë dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me kuadrin ligjor vendas.

6. Banka e Shqipërisë e njofton Komisionin Evropian për të gjitha licencimet e degëve të institucioneve të parasë elektronike që e kanë zyrën e tyre qendrore në vende të treta.

Neni 28/7

Hapja e degës së institucionit të parasë elektronike në një vend të tretë

1. Një institucion i parasë elektronike i licencuar nga Banka e Shqipërisë mund të ushtrojë veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike në një vend të tretë nëpërmjet një dege. Për këtë qëllim, institucioni i parasë elektronike merr miratimin e Bankës së Shqipërisë.

2. Për qëllime të hapjes së një dege në një vend të tretë, institucioni i parasë elektronike i paraqet Bankës së Shqipërisë një aplikim për dhënien e miratimit, të shoqëruar me të dhënat dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe adresën e degës;

b) përshkrimin e strukturës organizative të degës;

c) planin e biznesit të degës për 3 vjetët e parë të veprimtarisë dhe përshkrimin e veprimtarive që synon të ofrojë nëpërmjet degës;

ç) të dhëna për personat që do të drejtojnë veprimtarinë e degës dhe për personat që do të drejtojnë drejtpërdrejt veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike në degë, të shoqëruara me të dhëna dhe evidenca për reputacion të mirë profesional dhe kualifikime e përvojë të përshtatshme profesionale, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe akteve nënligjore përkatëse.

3. Banka e Shqipërisë mund të përcaktojë me akt nënligjor kërkesa shtesë, përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni.

4. Nëse informacioni i paraqitur sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni nuk është i plotë, Banka e Shqipërisë brenda një muaji nga marrja e aplikimit njofton institucionin e parasë elektronike për plotësimin e informacionit të nevojshëm. Në rast të kërkesës për informacion shtesë, data e pranimit të aplikimit llogaritet nga dita e paraqitjes së informacionit të plotë.

5. Banka e Shqipërisë vendos mbi aplikimin e paraqitur nga institucioni i parasë elektronike për hapjen e degës në një vend të tretë brenda 3 muajve nga data e pranimit të aplikimit të plotë.

6. Banka e Shqipërisë refuzon kërkesën për hapjen e një dege në një vend të tretë nëse, bazuar në informacionin në dispozicion, vlerëson se:

a) institucioni i parasë elektronike që synon të hapë degën nuk ka strukturë të përshtatshme organizative dhe teknike ose një situatë financiare që i mundëson ushtrimin e veprimtarisë së planifikuar në vendin e tretë;

b) duke konsideruar kuadrin ligjor e rregullativ të vendit të tretë ose praktikat për zbatimin e tij, ka dyshime që ushtrimi i mbikëqyrjes në përputhje me dispozitat e këtij ligji vështirësohet ose pengohet; ose

c) institucioni i parasë elektronike nëpërmjet hapjes së degës në vendin e tretë përpiqet të shmangë kërkesat e zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

7. Në rastet kur një institucion i parasë elektronike që ka marrë miratimin e Bankës së Shqipërisë për hapjen e një dege në një vend të tretë synon të hapë degë të tjera në atë vend, ai njofton për këtë Bankën e Shqipërisë. Dispozitat e pikave 2 deri në 6 të këtij neni nuk zbatohen në këto raste.

8. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor kushtet dhe procedurën e dhënies së miratimit ose refuzimit, të parashikuar në këtë nen.

9. Në rastet kur një institucion i parasë elektronike që ka marrë miratimin e Bankës së Shqipërisë për hapjen e një dege në një vend të tretë synon të ndryshojë ndonjë nga informacionet e parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, ai njofton për këtë Bankën e Shqipërisë të paktën një muaj përpara se ta bëjë këtë ndryshim.

10. Banka e Shqipërisë mund të shfuqizojë miratimin për hapjen e një dege në një vend të tretë nga një institucion i parasë elektronike kur:

a) konstatohet se institucioni i parasë elektronike nuk i përmbush më kërkesat organizative e teknike në lidhje me veprimtaritë që ushtron;

b) institucioni i parasë elektronike nuk respekton kuadrin ligjor e rregullativ të vendit pritës gjatë ushtrimit të veprimtarisë së degës; ose

c) nga shpërndarja territoriale e ofrimit të shërbimeve është e qartë se institucioni i parasë elektronike në këtë mënyrë përpiqet të shmangë kërkesat e zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

11. Banka e Shqipërisë shfuqizon miratimin për hapjen e një dege në një vend të tretë nga një institucion i parasë elektronike kur:

a) autoriteti përgjegjës i vendit pritës i ka ndaluar institucionit të parasë elektronike ushtrimin e veprimtarisë në territorin e tij;

b) dega nuk fillon veprimtarinë brenda 6 muajve nga marrja e miratimit;

c) dega nuk ka ushtruar veprimtaritë e përfshira në licencë për më shumë se 6 muaj; ose

ç) institucioni i parasë elektronike ka marrë miratimin për hapjen e degës mbi bazën e të dhënave të rreme ose të pasakta, të cilat kanë qenë të rëndësishme për dhënien e miratimit.

12. Banka e Shqipërisë ushtron funksionin e saj mbikëqyrës edhe për degët e institucioneve të parasë elektronike të licencuara prej saj që ushtrojnë veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike në një vend të tretë.

13. Për qëllime të ushtrimit të funksionit mbikëqyrës, të parashikuar në pikën 12 të këtij neni, Banka e Shqipërisë bashkëpunon edhe me autoritetet mbikëqyrëse të vendit të tretë, sipas parashikimeve të nenit 26/4 të këtij ligji.

Neni 28/8

Përjashtime opsionale

1. Banka e Shqipërisë mund të lejojë moszbatimin e të gjitha ose të një pjese të procedurave dhe kërkesave të parashikuara në nenet 28/1, 28/2, 28/3 dhe 28/5 të këtij ligji, me përjashtim të neneve 24, 26, 26/1, 96 dhe 97 të këtij ligji, si dhe të lejojë që personat juridikë të regjistrohen në regjistrin për institucionet e parasë elektronike, nëse përmbushen njëkohësisht kërkesat e mëposhtme:

a) aktiviteti total i biznesit të personit juridik gjeneron një tepricë mesatare të parasë elektronike që nuk tejkalon limitin e vendosur nga Banka e Shqipërisë me akt nënligjor, që në çdo rast nuk tejkalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 5 milionë euro;

b) asnjë nga personat përgjegjës për administrimin apo ushtrimin e veprimtarisë të mos jetë dënuar për vepra penale të lidhura me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit ose në fushën financiare.

Në rastet kur një institucion i parasë elektronike kryen ndonjë nga veprimtaritë e parashikuara në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 28/4 të këtij ligji, që nuk lidhen me emetimin e parasë elektronike, ose ndonjë nga veprimtaritë e parashikuara në shkronjat “b” deri në “d” të pikës 1 të nenit 28/4 të këtij ligji dhe vlera e tepricës së parasë elektronike nuk dihet paraprakisht, Banka e Shqipërisë lejon që ky institucion i parasë elektronike të zbatojë shkronjën “a” të kësaj pike, në bazë të një pjese përfaqësuese që supozohet se do të përdoret për emetimin e parasë elektronike, me kusht që kjo pjesë përfaqësuese të mund të vlerësohet në mënyrë të arsyeshme në bazë të të dhënave historike dhe të përmbushë kërkesat e Bankës së Shqipërisë. Kur institucioni i parasë elektronike në ushtrimin e aktivitetit të tij nuk ka mbushur afatin e përcaktuar në kuadrin nënligjor të Bankës së Shqipërisë, kjo kërkesë do të kryhet në bazën e parashikimit të tepricës së parasë elektronike, siç parashikohet në planin e tij të biznesit, duke konsideruar edhe rishikimet e propozuara nga Banka e Shqipërisë në këtë plan biznesi (nëse është e aplikueshme).

Banka e Shqipërisë, në rastet kur lejon përjashtimet sipas këtij neni, mund të aplikojë një kërkesë shtesë për përcaktimin e shumës maksimale të ruajtur në instrumentin e pagesës ose llogarinë e pagesës së konsumatorit ku mbahet paraja elektronike.

Një person juridik i regjistruar në përputhje me këtë pikë mund të ofrojë shërbime pagesash që nuk lidhen me paranë elektronike, të emetuar në përputhje me këtë nen, vetëm nëse plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 27 të këtij ligji.

2. Çdo person juridik i regjistruar në përputhje me pikën 1 të këtij neni duhet ta ketë zyrën e tij qendrore në Republikën e Shqipërisë, ku edhe ushtron veprimtarinë e tij.

3. Një person juridik i regjistruar në përputhje me pikën 1 të këtij neni konsiderohet dhe trajtohet si institucion i parasë elektronike. Parashikimet e nenit 13, pika 9, dhe të neneve 26/3, 26/4 dhe 26/6 të këtij ligji nuk zbatohen për këtë person.

4. Banka e Shqipërisë mund të lejojë një person juridik të regjistruar në përputhje me pikën 1 të këtij neni të ushtrojë vetëm disa nga veprimtaritë e parashikuara në nenin 28/4, pika 1, të këtij ligji, sipas përcaktimeve, rast pas rasti.

5. Një person juridik i referuar në pikën 1 të këtij neni duhet:

a) të njoftojë Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim në situatën e tij, që është i rëndësishëm për kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni; dhe

b) të paktën çdo vit, deri në datën 30 janar, të raportojë tepricën mesatare të parasë elektronike.

6. Në rastet kur kushtet e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 4 të këtij neni nuk përmbushen më, personi juridik në fjalë duhet të aplikojë për licencim në Bankën e Shqipërisë brenda 30 ditëve kalendarike, në përputhje me nenin 28/1 të këtij ligji. Çdo person që nuk ka aplikuar për licencim brenda kësaj periudhe kohore ndalohet të emetojë para elektronike, në përputhje me nenin 28/9 të këtij ligji.

7. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të verifikojë përputhshmërinë e vazhdueshme me kërkesat e përcaktuara në këtë nen.

8. Kërkesat e këtij neni nuk zbatohen në lidhje me legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

9. Banka e Shqipërisë informon Komisionin Evropian për numrin e personave juridikë të përjashtuar sipas këtij neni dhe, në baza vjetore, për tepricën totale të parasë elektronike të emetuar më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik, siç parashikohet në pikën 1 të këtij neni.

Seksioni 2
Emetimi dhe ripagimi i fondeve të parasë elektronike

Neni 28/9
Ndalimi i emetimit të parasë elektronike

Asnjë person fizik apo juridik që nuk është emetues i parasë elektronike, sipas përcaktimeve të këtij ligji, nuk mund të emetojë para elektronike.

Neni 28/10
Emetimi i parasë elektronike dhe ripagimi i fondeve

1. Emetuesi i parasë elektronike emeton para elektronike për një vlerë të barabartë me vlerën nominale (*at par value*) të fondeve të marra nga mbajtësi i parasë elektronike.

2. Emetuesi i parasë elektronike, me kërkesë të mbajtësit të parasë elektronike, i ripaguan atij në çdo moment dhe në vlerë nominale (*at par value*) vlerën monetare të parasë elektronike të mbajtur prej tij.

3. Kontrata midis emetuesit të parasë elektronike dhe mbajtësit të parasë elektronike duhet të përcaktojë qartë dhe në formë të kuptueshme kushtet e ripagimit të fondeve, duke përfshirë çdo tarifë që lidhet me to. Kontrata hartohet në gjuhën shqipe ose në një gjuhë tjetër të dakordësuar ndërmjet palëve. Emetuesi i

parasë elektronike informon mbajtësin e parasë elektronike për kushtet e kontratës para nënshkrimit të saj.

4. Ripagimi i fondeve mund të jetë subjekt i aplikimit të tarifave, vetëm nëse përcaktohet në kontratë, në përputhje me pikën 3 të këtij neni dhe vetëm në një nga rastet e mëposhtme:

a) kur kërkohet ripagimi i fondeve para afatit të përfundimit të kontratës;

b) kur kontrata parashikon një datë përfundimi dhe mbajtësi i parasë elektronike e zgjidh kontratën para asaj date; ose

c) kur kërkohet ripagimi i fondeve më shumë se një vit pas datës së përfundimit të kontratës.

Çdo tarifë e aplikuar duhet të jetë proporcionale dhe në përputhje me kostot reale të emetuesit të parasë elektronike.

5. Kur ripagimi i fondeve kërkohet para afatit të përfundimit të kontratës, mbajtësi i parasë elektronike mund të kërkojë ripagimin e plotë ose të pjesshëm të parasë elektronike.

6. Kur kërkohet ripagimi i fondeve nga mbajtësi i parasë elektronike një vit ose deri në një vit pas datës së përfundimit të kontratës:

a) emetuesi i parasë elektronike ripaguan vlerën totale monetare të parasë elektronike të mbajtur prej mbajtësit të parasë elektronike; ose

b) kur institucioni i parasë elektronike kryen një ose më shumë nga veprimtaritë e parashikuara në nenin 28/4, pika 1, shkronja “d”, të këtij ligji, dhe nuk dihet paraprakisht se cila pjesë e fondeve do të përdoret si para elektronike, emetuesi i parasë elektronike do të ripaguajë të gjitha fondet e kërkuara nga mbajtësi i parasë elektronike.

7. Pavarësisht parashikimeve të pikave 4, 5 dhe 6, të kësaj pike, të drejtat e ripagimit të një personi që nuk është konsumator, i cili pranon para elektronike, janë subjekt i dispozitave të marrëveshjes kontraktuale midis emetuesit të parasë elektronike dhe atij personi.

Neni 28/11

Ndalimi i pagimit të interesit

Emetuesi i parasë elektronike ndalohet t’i paguajë interes ose ndonjë përfitim tjetër mbajtësit të parasë elektronike për periudhën gjatë së cilës ky i fundit mban paranë elektronike.

Neni 28/12

Trajtimi i ankesave dhe procedurat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve

Kreu VI i titullit IV të këtij ligji zbatohet me ndryshimet përkatëse (*mutatis mutandis*) edhe për mbajtësit e parasë elektronike dhe emetuesit e parasë elektronike, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre të parashikuara në këtë seksion.”.

Neni 25

Kreu II “DISPOZITA TË PËRBASHKËTA” i titullit II rinumërohet kreu III “DISPOZITA TË PËRBASHKËTA” dhe në fillim të kreut III shtohet seksioni 1 me titull “Kërkesa të përbashkëta”.

Neni 26

Në nenin 29 bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën “b” të pikës 1 pas fjalëve “me të drejtat e detyrimet” shtohen fjalët “dhe përfitimet”.

2. Pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet për sistemet e pagesave që përbëhen ekskluzivisht vetëm nga ofrues të shërbimeve të pagesave që i përkasin një grupi.

3. Kur një pjesëmarrës në një sistem pagesash të rregulluar nga legjislacioni për sistemet e pagesave, që funksionon sipas parimit të finalitetit të shlyerjes, i lejon një ofruesi të shërbimeve të pagesave të licencuar ose të regjistruar, që nuk është pjesëmarrës në këtë sistem, të kalojë urdhërpagesa nëpërmjet këtij sistemi, ky pjesëmarrës, kur i kërkohet, duhet t’u japë të njëjtën mundësi, në mënyrë objektive, proporcionale dhe jodiskriminuese, edhe ofruesve të tjerë të shërbimeve të pagesave, të licencuar ose të regjistruar, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni. Në rast se pjesëmarrësi refuzon, ai i paraqet ofruesit të shërbimeve të pagesave arsyet e plota të refuzimit.”.

Neni 27

Pas nenit 29 shtohen nenet 29/1 dhe 29/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 29/1

Kushtet për të kërkuar pjesëmarrje në sistemet e pagesave që funksionojnë sipas parimit të finalitetit të shlyerjes

1. Për të garantuar stabilitetin dhe integritetin e sistemeve të pagesave, të rregulluar nga legjislacioni për sistemet e pagesave~~,~~ dhe që funksionojnë sipas parimit të finalitetit të shlyerjes, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike që kërkojnë të marrin pjesë dhe ato që marrin pjesë në këto sisteme duhet të disponojnë:

a) një përshkrim të masave të marra për mbrojtjen e fondeve të përdoruesve të shërbimeve të pagesave;

b) një përshkrim të mekanizmave qeverisës dhe të kontrollit të brendshëm për shërbimet e pagesave ose shërbimet e parasë elektronike, që synon të ofrojë, duke përfshirë procedurat administrative, procedurat e administrimit të rrezikut dhe procedurat kontabël të institucionit të pagesave ose të institucionit të parasë

elektronike, si dhe një përshkrim të marrëveshjeve kontraktuale për përdorimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, të institucionit të pagesave ose të institucionit të parasë elektronike, sipas kërkesave për sistemin e administrimit të rrezikut të TIK-ut dhe për sistemet, protokollet dhe mekanizmat e TIK-ut të parashikuara në kuadrin nënligjor për qëndrueshmërinë operacionale digjitale dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, siç përcaktohet në nenet 6 dhe 7 të rregullores (BE) 2022/2554; dhe

c) një plan për likuidimin në rast dështimi.

2. Për qëllime të shkronjës "a" të pikës 1 të këtij neni:

a) në rastet kur institucioni i pagesave ose institucioni i parasë elektronike mbron fondet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave, duke depozituar fonde në një llogari të veçantë në një institucion krediti ose nëpërmjet investimit në aktive të sigurta, likuide dhe me rrezik të ulët, siç përcaktohet me akt nënligjor nga Banka e Shqipërisë, përshkrimi i masave të marra për këtë mbrojtje të fondeve duhet të përmbajë, sipas rastit:

i. një përshkrim të politikës së investimit, për të siguruar që aktivet e zgjedhura janë likuide, të sigurta dhe me rrezik të ulët;

ii. numrin e personave që kanë akses në llogarinë e mbrojtjes së fondeve dhe funksionet e tyre;

iii. një përshkrim të procesit të administrimit dhe rakordimit, për të siguruar që fondet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave janë të veçuara e të mbrojtura në interes të përdoruesve të shërbimeve të pagesave, kundrejt pretendimeve të kreditorëve të tjerë të institucionit të pagesave ose institucionit të parasë elektronike, veçanërisht në rast të falimentimit të këtij të fundit;

iv. një kopje të projektkontratës tip me institucionin e kreditit;

v. një deklaratë të qartë të institucionit të pagesave ose të institucionit të parasë elektronike për përputhshmërinë me nenin 12 të këtij ligji;

b) në rastet kur institucioni i pagesave ose institucioni i parasë elektronike mbron fondet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave nëpërmjet një police sigurimi ose me një garanci tjetër të krahasueshme me të, të lëshuar nga një shoqëri sigurimi ose nga një institucion krediti, përshkrimi i masave të marra për këtë mbrojtje duhet të përmbajë:

i. një konfirmim nga vetë subjekti që polica e sigurimit ose garancia e krahasueshme me të nga një shoqëri sigurimi ose një institucion krediti është lëshuar nga një subjekt që nuk i përket të njëjtit grup të institucionit të pagesave ose institucionit të parasë elektronike;

ii. detajet e procesit të rakordimit, të zbatueshme, që sigurojnë se polica e sigurimit ose garancia e krahasueshme me të është e mjaftueshme për të përmbushur në çdo kohë detyrimet e institucionit të pagesave ose institucionit të parasë elektronike për mbrojtjen e fondeve;

iii. kohëzgjatjen dhe kushtet e rinovimit të mbulimit nga polica e sigurimit ose garancia e krahasueshme me të;

iv. një kopje të kontratës së sigurimit ose marrëveshjes së garancisë së krahasueshme ose kopje të projekteve të kësaj kontrate.

3. Për qëllime të shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni, përshkrimi duhet të tregojë se mekanizmat qeverisës e të kontrollit të brendshëm dhe marrëveshjet kontraktuale për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, siç parashikohen në atë shkronjë, janë proporcionale, të përshtatshme, të sigurta dhe të mjaftueshme. Përveç kësaj, mekanizmat qeverisës dhe të kontrollit të brendshëm do të përfshijnë:

a) një hartë të rreziqeve të identifikuara nga institucioni i pagesave ose nga institucioni i parasë elektronike, duke përfshirë llojin e rreziqeve dhe procedurat që institucioni i pagesave ose institucioni i parasë elektronike ka zbatuar ose do të zbatojë, për të vlerësuar dhe parandaluar rreziqe të tilla;

b) procedurat e ndryshme për të kryer kontrolle periodike dhe të vazhdueshme, përfshirë shpeshtësinë e këtyre kontrolleve dhe burimet njerëzore të alokuara për këtë qëllim;

c) procedurat kontabël me të cilat institucioni i pagesave ose institucioni i parasë elektronike regjistron dhe raporton informacionin e tij financiar;

ç) identitetin e personit ose personave përgjegjës për funksionet e kontrollit të brendshëm, duke përfshirë edhe kontrollin periodik, të vazhdueshëm dhe të përputhshmërisë, si dhe një *curriculum vitae* (CV) të përditësuar të atij personi ose atyre personave;

d) identitetin e çdo auditori që nuk është auditues ligjor, siç përcaktohet në legjislacionin për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar;

dh) përbërjen e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, të komitetit të kontrollit, si dhe të ndonjë komiteti tjetër në nivel këshilli administrimi/mbikëqyrës (nëse është e aplikueshme);

e) një përshkrim të mënyrës se si monitorohen dhe kontrollohen funksionet e transferuara te palë të treta, për të shmangur dëmtimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm të institucionit të pagesave ose të institucionit të parasë elektronike;

ë) një përshkrim të mënyrës se si monitorohet dhe kontrollohet çdo agjent dhe degë brenda sistemit të kontrollit të brendshëm të institucionit të pagesave ose të institucionit të parasë elektronike;

f) një përshkrim të organeve drejtuese dhe të subjekteve që përbëjnë grupin, në rastet kur institucioni i pagesave ose institucioni i parasë elektronike është filial i një subjekti të rregulluar në një shtet anëtar.

4. Për qëllime të shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni, plani për likuidimin duhet të përshtatet me madhësinë e parashikuar dhe modelin e biznesit të institucionit të pagesave ose të institucionit të parasë elektronike dhe duhet të përfshijë një përshkrim të masave lehtësuese që do të zbatohen nga institucioni i pagesave ose institucioni i parasë elektronike në rastin e përfundimit të shërbimeve të pagesave prej tij, i cili do të siguronte ekzekutimin e transaksioneve të pagesave në pritje (në proces) dhe zgjidhjen e kontratave ekzistuese.

5. Banka e Shqipërisë përcakton procedurën për vlerësimin e përmbushjes së kërkesave të parashikuara në pikat 1 deri në 4 të këtij neni. Kjo procedurë mund të jetë në formën e vetëvlerësimit, të një kërkese për një vendim të qartë nga Banka e

Shqipërisë ose të çdo procedure tjetër që synon të garantojë respektimin e kërkesave të parashikuara në pikat 1 deri në 4 të këtij neni nga institucionet e pagesave ose institucionet e parasë elektronike në fjalë.

Neni 29/2

Informimi i konsumatorëve për të drejtat e tyre

1. Banka e Shqipërisë publikon një fletë informuese elektronike për të drejtat e konsumatorëve, sipas kërkesave të këtij ligji, në mënyrë lehtësisht të aksesueshme në faqen e saj të internetit, bazuar në fletën informuese përkatëse të publikuar nga Komisioni Evropian.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave publikojnë fletën informuese të parashikuar në pikën 1 të këtij neni në një formë lehtësisht të aksesueshme në faqen e tyre zyrtare të internetit, nëse ekziston një e tillë, dhe në formë letre në degët, agjentët dhe në çdo palë të tretë që i janë transferuar funksionet.

3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave e vënë fletën informuese në dispozicion të konsumatorëve pa pagesë.

4. Banka e Shqipërisë dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave sigurohen që informacioni i përfshirë në fletën informuese të publikohet edhe nëpërmjet mjeteve alternative ose në formate alternative, në mënyrë që të jetë i aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara.”.

Neni 28

Në nenin 31 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 2 fjalia “Mbi bazën e këtij njoftimi, Banka e Shqipërisë merr një vendim të mirargumentuar për vazhdimësinë ose jo të përjashtimit dhe informon ofruesin e shërbimeve.” zëvendësohet me fjalinë “Mbi bazën e këtij njoftimi, Banka e Shqipërisë merr një vendim të mirargumentuar, bazuar në kriteret e parashikuara në shkronjën “gj” të nenit 4 të këtij ligji, nëse veprimtaria nuk kualifikohet si rrjet i kufizuar, dhe informon për këtë ofruesin e shërbimeve.”.

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Pavarësisht pikës 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë informon Autoritetin Bankar Evropian për shërbimet e njoftuara, në përputhje me pikat 2 dhe 3 të këtij neni, duke përcaktuar se në cilin lloj përjashtimi kryhet veprimtaria.”.

Neni 29

Në fund të seksionit 1 të kreut III të titullit II, pas nenit 31 shtohet seksioni 2 me titull “Riorganizimi juridik” që përmban nenet 31/1, 31/2, 31/3 dhe 31/4 me këtë përmbajtje:

“Seksioni 2

Riorganizimi juridik

Neni 31/1

Riorganizimi juridik nëpërmjet bashkimit me përthithje ose me krijim

1. Riorganizimi juridik nëpërmjet bashkimit të një institucioni pagesash ose të një institucioni të parasë elektronike kryhet sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Riorganizimi juridik nëpërmjet bashkimit të një institucioni pagesash ose një institucioni të parasë elektronike nuk mund të kryhet pa miratimin e Bankës së Shqipërisë.

3. Një institucion pagesash mund të bashkohet vetëm me një institucion tjetër pagesash dhe një institucion i parasë elektronike mund të bashkohet vetëm me një institucion tjetër të parasë elektronike.

4. Nëse institucionet e pagesave ose institucionet e parasë elektronike bashkohen duke krijuar një institucion të ri pagesash ose institucion të ri të parasë elektronike, subjekti që krijohet si rezultat i bashkimit me krijim duhet t'u nënshtrohet të gjitha procedurave për licencim dhe të përmbushë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Neni 31/2

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për bashkimin me përthithje ose me krijim

1. Për të marrë miratimin për bashkimin me përthithje, institucioni përthithës i pagesave ose institucioni përthithës i parasë elektronike njofton Bankën e Shqipërisë brenda 15 ditëve nga data e lidhjes së marrëveshjes së bashkimit dhe i paraqet një kërkesë me shkrim, të shoqëruar me informacionet dhe dokumentacionin e përcaktuar në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

2. Për të marrë miratimin për bashkimin me krijim në rastin e bashkimit të institucioneve të pagesave ose institucioneve të parasë elektronike, duke krijuar një institucion të ri pagesash ose institucion të ri të parasë elektronike, subjektet që bashkohen duhet t'i paraqesin Bankës së Shqipërisë një kërkesë për miratimin e bashkimit me krijim, së cilës i bashkëngjiten dokumentet dhe informacionet e përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji dhe në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Neni 31/3

Shqyrtimi i kërkesës dhe vendimi për bashkimin me përthithje ose me krijim

1. Banka e Shqipërisë shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti përthithës për bashkimin me përthithje, me qëllim vlerësimin nëse subjekti përthithës ka kapacitete teknike, administrative dhe operacionale, si dhe

kapital të mjaftueshëm për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe/ose shërbimeve të parasë elektronike.

2. Banka e Shqipërisë shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti për bashkimin me krijim, në përputhje me nenin 13 të këtij ligji, si dhe nëse subjekti plotëson kërkesat që burojnë nga neni 7 i këtij ligji dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

3. Banka e Shqipërisë merr vendim për dhënien ose refuzimin e miratimit për bashkimin me përthithje ose me krijim, brenda 3 muajve nga data e plotësimit të dokumentacionit të kërkuar.

4. Banka e Shqipërisë i njofton vendimin për dhënien e miratimit ose për refuzimin e bashkimit institucionit përthithës të pagesave ose institucionit përthithës të parasë elektronike, ose institucionit të ri të pagesave ose institucionit të ri të parasë elektronike që krijohet nga bashkimi me krijim. Në rastin e refuzimit, Banka e Shqipërisë argumenton arsyet e refuzimit në vendimin përkatës.

5. Banka e Shqipërisë shfuqizon licencën e institucionit të pagesave ose të parasë elektronike që përthithet në bashkim dhe e përfshin në vendimin për dhënien e miratimit për bashkim të institucionit përthithës të pagesave ose të parasë elektronike.

6. Banka e Shqipërisë shfuqizon licencat e institucioneve të pagesave ose institucioneve të parasë elektronike që bashkohen, duke krijuar një institucion të ri pagesash ose institucion të ri të parasë elektronike dhe e përfshin në vendimin për dhënien e licencës për ushtrimin e veprimtarisë të institucionit të ri, të krijuar si rezultat i bashkimit. Vendimi hyn në fuqi pas datës së regjistrimit të subjektit të ri në regjistrin tregtar.

7. Banka e Shqipërisë publikon vendimin për dhënien e miratimit për bashkimin me përthithje ose me krijim në Buletinin Zyrtar dhe njoftimin për këtë bashkim në faqen e saj të internetit. Banka e Shqipërisë bën ndryshimet përkatëse në regjistrin e subjekteve, të parashikuar në nenin 16 të këtij ligji.

Neni 31/4

Njoftimi i bashkimit me përthithje ose me krijim nga subjektet

1. Institucionet e pagesave ose institucionet e parasë elektronike që bashkohen duhet të publikojnë menjëherë njoftimin për bashkimin në të paktën një media kombëtare dhe në faqen e internetit të subjektit, nëse ekziston.

2. Institucioni përthithës i pagesave ose i parasë elektronike ose institucioni i ri i pagesave ose i parasë elektronike duhet të paraqesë menjëherë një kërkesë për regjistrimin e bashkimit në regjistrin tregtar pas marrjes së miratimit përkatës nga Banka e Shqipërisë.”.

Neni 30

Në nenin 32 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 2 shtohen pikat 2/1 dhe 2/2 me këtë përmbajtje:

“2/1. Ky titull do të zbatohet për transaksionet e pagesave në lek dhe euro në rastin kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, si edhe në rastin kur në transaksionin e pagesës është i përfshirë vetëm një ofrues i shërbimeve të pagesave, i cili ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2/2. Kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, ky titull do të zbatohet edhe për transaksionet e pagesave në monedhën e çdo shteti anëtar në rastin kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës ndodhet në një shtet tjetër anëtar, ose kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit ndodhet në një shtet tjetër anëtar.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Ky titull, me përjashtim të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 38, të nënndarjes “v” të shkronjës “b” të nenit 45 dhe të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 49 të këtij ligji, do të zbatohet për transaksionet e pagesave në monedha të ndryshme nga lek dhe euro në rastin kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, si edhe në rastin kur në transaksionin e pagesës është i përfshirë vetëm një ofrues i shërbimeve të pagesave, i cili ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, për atë pjesë të transaksionit të pagesës që kryhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, ky titull, me përjashtim të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 38, të nënndarjes “v” të shkronjës “b” të nenit 45 dhe të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 49 të këtij ligji, do të zbatohet edhe për transaksionet e pagesave në një monedhë të ndryshme nga monedha e çdo shteti anëtar në rastin kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës ndodhet në një shtet tjetër anëtar, ose kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit ndodhet në një shtet tjetër anëtar, për atë pjesë të transaksionit të pagesës që kryhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.”.

4. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Ky titull, me përjashtim të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 38, të nënndarjes “v” të shkronjës “b” të nenit 45, të nënndarjes “vii” të shkronjës “d” të nenit 45 dhe të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 49 të këtij ligji, zbatohet për transaksionet e pagesave, në të gjitha monedhat, kur njëri nga ofruesit e shërbimeve të pagesave ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ofruesi ose ofruesit e tjerë të shërbimeve të pagesave ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për ato pjesë të transaksionit të pagesës që kryhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.”.

5. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, ky titull, me përjashtim të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 38, të nënndarjes “v” të shkronjës “b” të nenit 45, të nënndarjes “vii” të shkronjës “d” të nenit 45 dhe të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 49 të këtij ligji, do të zbatohet edhe për transaksionet e pagesave ndërkombëtare, në të gjitha monedhat, kur njëri nga ofruesit e shërbimeve të pagesave ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ofruesi ose ofruesit e tjerë të shërbimeve të pagesave ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për ato pjesë të transaksionit të pagesës që kryhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 31

Pas nenit 32 shtohet neni 32/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 32/1
Aplikimi i dispozitave të akteve të tjera ligjore

1. Dispozitat e këtij titulli nuk cenojnë zbatimin e çdo legjislacioni tjetër në Republikën e Shqipërisë dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, të çdo legjislacioni tjetër të Bashkimit Evropian, ku parashikohen kërkesa shtesë për informacionin paraprak të përdoruesve të shërbimeve.

2. Në rastet kur janë të zbatueshme dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit, që parashikojnë kriteret e informacionit për kontratat në distancë për shërbimet financiare konsumatore, ato dispozita do të zëvendësohen nga kërkesat e parashikuara në nenet 37, 38, 44 dhe 45 të këtij ligji, me përjashtim të dispozitave të mëposhtme për të cilat do të zbatohen edhe kërkesat përkatëse, të parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorit:

a) njoftimi se shërbimi financiar lidhet me instrumente që përfshijnë rreziqe të veçanta për shkak të karakteristikave të tyre specifike ose të operacioneve që do të ekzekutohen, ose të çmimit të tyre që varet nga luhatjet e tregjeve të instrumenteve financiare jashtë kontrollit të tregtarit, si dhe njoftimi se performancat e mëparshme nuk përbëjnë tregues për performancat e ardhshme;

b) njoftimi për mundësinë e ekzistencës së taksave dhe/ose kostove të tjera që nuk paguhen përmes tregtarit dhe që nuk vendosen prej tij;

c) kufizime, nëse ka, të afatit për të cilin vlen informacioni i dhënë;

ç) mënyrat e pagesës dhe të përmbushjes së kontratës;

d) çdo kosto shtesë specifike për konsumatorin për përdorimin e mjeteve të komunikimit në distancë, nëse një kosto e tillë shtesë tarifohet;

dh) ekzistenca ose mungesa e së drejtës së tërheqjes dhe, kur kjo e drejtë ekziston, informacion për afatin e tërheqjes dhe kushtet për ushtrimin e kësaj të drejte, përfshirë informacion për shumën që konsumatori mund të detyrohet të paguajë, si dhe pasojat nga mosushtrimi i kësaj të drejte;

e) udhëzimet praktike dhe procedurat për ushtrimin e së drejtës së heqjes dorë, duke përfshirë, ndër të tjera, numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike të tregtarit ose të dhëna të mjeteve të tjera të komunikimit relevante për dërgimin e

deklaratës së tërheqjes dhe për kontratat e shërbimeve financiare të lidhura përmes një ndërfaqeje *online* informacion për ekzistencën dhe vendndodhjen e funksionit të tërheqjes;

ë) ekzistenca e fondeve të garancisë ose të mekanizmave të tjerë të kompensimit, për aq sa këto nuk u nënshtrohen rregullimeve të posaçme ligjore për skemat e sigurimit të depozitave dhe skemat e kompensimit të investitorëve.".

Neni 32

Në nenin 35 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) paragrafi i parë i pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Në rastet e instrumenteve të pagesave, të cilat sipas kontratës përkatëse tip kanë të bëjnë vetëm me transaksione individuale pagese, që nuk tejkalojnë vlerën ekuivalente në lekë të shumës prej 30 eurosh, ose kanë një limit shpenzimi në vlerën ekuivalente në lekë të shumës prej 150 eurosh, ose ruajnë vlera që nuk tejkalojnë vlerën ekuivalente në lekë të shumës prej 150 eurosh, në çdo kohë:".

b) në shkronjën "a" fjalët "me përjashtim të neneve 44, 45 e 49" zëvendësohen me fjalët "pavarësisht kërkesave të përcaktuara në nenet 44, 45 e 49".

c) në shkronjën "b" fjalët "në përjashtim nga neni 47 i këtij ligji" zëvendësohen me fjalët "pavarësisht kërkesave të përcaktuara në nenin 47 të këtij ligji".

ç) në shkronjën "c" fjalët "në përjashtim nga nenet 50 dhe 51" zëvendësohen me fjalët "pavarësisht kërkesave të përcaktuara në nenet 50 dhe 51 të këtij ligji".

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Banka e Shqipërisë, për transaksionet e pagesave kombëtare, me akt nënligjor mund të ulë ose të dyfishojë limitet sipas pikës 1 të këtij neni. Për instrumentet e pagesave të parapaguara, limiti mund të rritet deri në vlerën ekuivalente në lekë të shumës prej 500 eurosh.".

Neni 33

Në nenin 37, pika 1, dy fjalitë e fundit "Me kërkesën e përdoruesit të shërbimeve të pagesave, ofruesi i shërbimeve të pagesave duhet të japë informacionin dhe kushtet e shërbimit, të shkruara në letër ose në një formë tjetër të qëndrueshme komunikimi. Këto informacione dhe kushte duhet të shprehen me fjalë lehtësisht të kuptueshme dhe në një formë të qartë, të paktën në gjuhën shqipe." zëvendësohen me fjalitë "Me kërkesën e përdoruesit të shërbimeve të pagesave, ofruesi i shërbimeve të pagesave duhet të japë informacionin dhe kushtet e shërbimit, në letër ose në një mjet tjetër të qëndrueshëm komunikimi. Këto informacione dhe kushte duhet të shprehen me fjalë lehtësisht të kuptueshme dhe në një formë të qartë dhe të plotë, në gjuhën shqipe ose në një gjuhë tjetër të dakordësuar ndërmjet palëve.".

Neni 34

Në nenin 38 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën “a” të pikës 1 fjalët “identifikuesin unik” zëvendësohen me fjalët “kodin unik të identifikimit”.

2. Shkronja “ç” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“ç) kur është e zbatueshme, kursin aktual apo referencë të këmbimit, të zbatueshëm për transaksionin e pagesës.”.

2. Shkronja “a” e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“a) emrin e ofruesit të shërbimit të inicimit të pagesës, adresën e zyrës qendrore dhe, kur është e zbatueshme, adresën e agjentit të tij dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, adresën gjeografike të agjentit të tij ose të degës në shtetin anëtar ku ofrohen shërbimet e pagesave, si dhe çdo informacion lidhur me kontaktin, duke përfshirë adresën e postës elektronike për komunikimin me ofruesin e shërbimit të inicimit të pagesës; dhe”.

Neni 35

Në shkronjën “ç” të nenit 39 fjalët “tarifën e çdo shpenzimi” zëvendësohen me fjalët “shumën e çdo tarife”.

Neni 36

Në shkronjën “c” të nenit 42 fjalët “shumën e tarifës së paguar” zëvendësohen me fjalët “shumën e tarifave të paguara”.

Neni 37

Pika 1 e nenit 44 ndryshohet si më poshtë:

“1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave, përpara se përdoruesi i shërbimeve të pagesave të nënshkruajë kontratën tip ose të angazhohet nëpërmjet një oferte, i jep përdoruesit të shërbimeve të pagesave, në letër ose në një mjet tjetër të qëndrueshëm komunikimi, informacionin dhe kushtet e përcaktuara në nenin 45 të këtij ligji. Informacioni dhe kushtet shprehen me fjalë lehtësisht të kuptueshme e në një formë të qartë dhe të plotë, në gjuhën shqipe ose në një gjuhë tjetër të dakordësuar ndërmjet palëve.”.

Neni 38

Në nenin 45 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Nënndarjet “i” dhe “ii” të shkronjës “a” ndryshohen si më poshtë:

“i. emrin e ofruesit të shërbimeve të pagesave, adresën e zyrës qendrore dhe, kur është e zbatueshme, adresën e agjentit të tij dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, adresën gjeografike të agjentit të tij ose të degës së themeluar në shtetin anëtar ku

ofrohen shërbimet e pagesave, si dhe çdo adresë tjetër, përfshirë adresën e postës elektronike për komunikimin me ofruesin e shërbimeve të pagesave;

ii. të dhëna identifikuese për regjistrimin në regjistrin e Bankës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve të nenit 16 të këtij ligji, ose regjistra të tjerë publikë përkatës për ofruesit e shërbimeve të pagesave, si dhe numrin e regjistrimit ose format ekuivalente të identifikimit në këta regjistra".

2. Nënndarja "vii" e shkronjës "b" ndryshohet si më poshtë:

"vii. në rastin e një instrumenti pagese të bazuar në kartë (*card-based*) me simbole të përbashkëta (*co-badged*), të drejtat e përdoruesit të shërbimeve të pagesave, sipas parashikimeve në aktin nënligjor të Bankës së Shqipërisë për tarifat e shkëmbimit dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, sipas parashikimeve të nenit 8 të rregullores (BE) 2015/751".

3. Në nënndarjet "iv" dhe "v" të shkronjës "d" fjala "detyrimin" zëvendësohet me fjalën "përgjegjësinë".

4. Nënndarja "vi" e shkronjës "d" ndryshohet si më poshtë:

"vi. përgjegjësinë e ofruesit të shërbimit të pagesave për inicimin ose ekzekutimin e transaksioneve të pagesave, në përputhje me nenet 82 dhe 83 të këtij ligji; dhe".

5. Nënndarja "i" e shkronjës "e" ndryshohet si më poshtë:

"i. çdo klauzolë kontraktore, që përcakton legjislacionin e zbatueshëm për kontratat tip dhe gjykatën kompetente".

Neni 39

Pas pikës 4 të nenit 48 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

"5. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë dispozitat e akteve të tjera ligjore, që rregullojnë të drejtat e palëve, për të deklaruar kontratën tip si të pazbatueshme ose të pavlefshme.".

Neni 40

Në fund të pikës 2 të nenit 52 pas fjalëve "dhe kursin e këmbimit" shtohen fjalët "që do të përdoret për konvertimin e transaksionit të pagesës".

Neni 41

Në nenin 54 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 fjalët "e nenit 57 dhe nenet 65, 67, 69, 70, 73 e 82 të këtij ligji" zëvendësohen me fjalët "e nenit 57 dhe neneve 65, 67, 69, 70, 73, 82 dhe 83 të këtij ligji.".

2. Pikat 4 dhe 5 ndryshohen si më poshtë:

"4. Ky titull do të zbatohet për transaksionet e pagesave në lek dhe euro, në rastin kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit dhe ofruesi i shërbimeve të

pagesave të përfituesit të pagesës ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, si edhe në rastin kur në transaksionin e pagesës është i përfshirë vetëm një ofrues i shërbimeve të pagesave, i cili ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, ky titull do të zbatohet edhe për transaksionet e pagesave në monedhën e çdo shteti anëtar, në rastin kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës ndodhet në një shtet tjetër anëtar, ose kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit ndodhet në një shtet tjetër anëtar.".

3. Pas pikës 5 shtohen pikat 6, 7, 8 dhe 9 me këtë përmbajtje:

"6. Ky titull, me përjashtim të neneve 74 deri në 78 dhe nenit 80 të këtij ligji, zbatohet për transaksionet e pagesave në monedha të ndryshme nga lek dhe euro, në rastin kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, si edhe në rastin kur në transaksionin e pagesës është i përfshirë vetëm një ofrues i shërbimeve të pagesave, i cili ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, për atë pjesë të transaksionit të pagesës që kryhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

7. Kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, ky titull, me përjashtim të neneve 74 deri në 78 dhe nenit 80 të këtij ligji, do të zbatohet edhe për transaksionet e pagesave në një monedhë të ndryshme nga monedha e çdo shteti anëtar, në rastin kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës ndodhet në një shtet tjetër anëtar, ose kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit ndodhet në një shtet tjetër anëtar, për atë pjesë të transaksionit të pagesës që kryhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

8. Ky titull, me përjashtim të neneve 55, pikat 2 dhe 3/1, të neneve 69, 70, 74, 76, pika 1, dhe të neneve 82 e 85 të këtij ligji, zbatohet për transaksionet e pagesave në të gjitha monedhat kur njëri nga ofruesit e shërbimeve të pagesave ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ofruesi ose ofruesit e tjerë të shërbimeve të pagesave ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për ato pjesë të transaksionit të pagesës që kryhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

9. Kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, ky titull, me përjashtim të neneve 55, pikat 2 dhe 3/1, të neneve 69, 70, 74, 76, pika 1, dhe të neneve 82 e 85 të këtij ligji, do të zbatohet edhe për transaksionet e pagesave ndërkombëtare në të gjitha monedhat kur njëri nga ofruesit e shërbimeve të pagesave ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ofruesi ose ofruesit e tjerë të shërbimeve të pagesave ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për ato pjesë të transaksionit të pagesës që kryhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.".

Neni 42

Në nenin 55 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1 fjalët “sipas neneve 72, pikat 1, 2 e 3, 73, pika 5, dhe 81, pika 2, të këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “në nenin 72, pikat 1 deri në 3, nenin 73, pika 5, dhe në nenin 81, pika 5, të këtij ligji”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Për transaksionet e pagesave të kryera brenda Republikës së Shqipërisë, kur si ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit, ashtu edhe ai i përfituesit të pagesës ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, ose kur ofruesi i vetëm i shërbimeve të pagesave i përfshirë në transaksionin e pagesës ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, paguesi dhe përfituesi i pagesës paguajnë tarifat e vëna përkatësisht nga ofruesit e tyre të shërbimeve të pagesave. Kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, për transaksionet e pagesave të ofruara në Bashkimin Evropian, kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës është i vendosur në një shtet tjetër anëtar, ose kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit është i vendosur në një shtet tjetër anëtar, paguesi dhe përfituesi i pagesës paguajnë tarifat e vëna përkatësisht nga ofruesit e tyre të shërbimeve të pagesave.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Përfituesi i pagesës nuk kërkon tarifa për përdorimin e instrumenteve të pagesës për të cilat tarifat e shkëmbimit rregullohen sipas aktit nënligjor të Bankës së Shqipërisë për tarifat e shkëmbimit dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, për të cilat tarifat e shkëmbimit rregullohen sipas kreut II të rregullores (BE) 2015/751. Përfituesi i pagesës nuk kërkon tarifa për ato shërbime pagese ndaj të cilave zbatohet kuadri nënligjor i Bankës së Shqipërisë për transfertat e kreditit dhe debitimin direkt dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, për ato shërbime pagese ndaj të cilave zbatohet rregullorja (BE) 260/2012.”.

4. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor kërkesat për tarifat e shkëmbimit dhe kërkesat teknike dhe të biznesit për transaksionet e pagesave të bazuara në kartë.”.

Neni 43

Në nenin 56 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Paragrafi i parë i pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Në rastet e instrumenteve të pagesave, të cilat sipas kontratës përkatëse tip kanë të bëjnë vetëm me transaksione individuale pagese, që nuk tejkalojnë vlerën ekuivalente në lekë të shumës prej 30 eurosh, ose kanë një limit shpenzimi në vlerën ekuivalente në lekë të shumës prej 150 eurosh, ose ruajnë vlera që nuk tejkalojnë vlerën ekuivalente në lekë të shumës prej 150 eurosh, në çdo kohë, ofruesit e shërbimeve të pagesave mund të bien dakord me përdoruesit e shërbimeve të pagesave të tyre, që:”.

2. Në shkronjën “c” të pikës 1 togfjalëshi “pikat 1 dhe 2” zëvendësohet me togfjalëshin “pikat 1, 2 dhe 3”.

3. Në pikën 2 fjalia “Për instrumentet e pagesave të parapaguara, limiti mund të rritet deri në një nivel të përcaktuar me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë.” zëvendësohet me fjalinë “Për instrumentet e pagesave të parapaguara, limiti mund të rritet deri në vlerën ekuivalente në lekë të shumës prej 500 eurosh.”.

4. Në pikën 3 fjalët “sipas përkufizimit në legjislacionin në fuqi për bankat” zëvendësohen me fjalët “sipas përcaktimeve të këtij ligji”.

5. Në pikën 4 pas fjalëve “mund të kufizojë” shtohen fjalët “me akt nënligjor”.

Neni 44

Në nenin 58 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 3 fjala “Konfirmimi” zëvendësohet me fjalët “Në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, konfirmimi”.

2. Në pikën 6 fjalët “e përkufizuar në legjislacionin në fuqi për bankat” zëvendësohet me fjalët “sipas përcaktimeve të këtij ligji.”.

Neni 45

Në nenin 59 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Një pagues ka të drejtën e përdorimit të një ofruesi të shërbimit të inicimit të pagesës për të marrë shërbimet e pagesave, të përcaktuara në pikën 7 të aneksit 1 të këtij ligji. Kjo e drejtë për përdorimin e një ofruesi të shërbimit të inicimit të pagesës nuk do të zbatohet në rastet kur llogaria e pagesave nuk është e aksesueshme *online*.”.

2. Në shkronjën “ç” të pikës 3 pas fjalëve “për shërbimin e llogarisë së paguesit dhe komunikon” shtohen fjalët “në mënyrë të sigurt”.

3. Në shkronjën “d” të pikës 3 pas fjalëve “të dhënat sensitive” shtohet fjala “të pagesës”.

4. Shkronja “b” e pikës 4 ndryshohet si më poshtë:

“b) menjëherë pas marrjes së urdhërpagesës nga një ofrues i shërbimit të inicimit të pagesës, jep ose vë në dispozicion të ofruesit të shërbimit të inicimit të pagesës të gjithë informacionin e mundur për inicimin e transaksionit të pagesës dhe të gjithë informacionin e aksesueshëm nga ofruesi i shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë në lidhje me ekzekutimin e transaksionit të pagesës.”.

5. Në shkronjën “c” të pikës 4 fjalët “në lidhje me urdhërpagesat e transmetuara drejtpërdrejt nga paguesi.” zëvendësohen me fjalët “kundrejt urdhërpagesave të transmetuara drejtpërdrejt nga paguesi.”.

Neni 46

Pika 1 e nenit 60 ndryshohet si më poshtë:

“1. Një përdorues i shërbimeve të pagesave ka të drejtën e përdorimit të shërbimeve, të cilat mundësojnë aksesin në informimin e llogarisë, sipas përcaktimit të pikës 8 të aneksit 1 të këtij ligji. Kjo e drejtë nuk do të zbatohet në rastet kur llogaria e pagesave nuk është e aksesueshme *online*.”.

Neni 47

Në nenin 61 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 pas fjalëve “Kur një instrument ” shtohet fjala “specifik”.

2. Në pikën 2 fjalët “instrumentin e pagesave për arsye të justifikuara objektive” zëvendësohen me fjalët “instrumentin e pagesës për arsye objektive të justifikuara”.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Në rastet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave informon paguesin për bllokimin e instrumentit të pagesës dhe për arsyet e këtij bllokimi, sipas formës së dakordësuar ndërmjet palëve, aty ku është e mundur, përpara bllokimit të instrumentit të pagesës dhe jo më vonë se menjëherë pas bllokimit, me përjashtim të rasteve kur ky informacion komprometon sigurinë për arsye objektive të justifikuara ose është i ndaluar me ligj.”.

4. Në pikën 6 fjalia “Ky informacion i jepet paguesit, aty ku është e mundur, përpara refuzimit të aksesit ose së paku menjëherë pas refuzimit të tij, përveç rasteve kur dhënia e informacionit komprometon sigurinë për arsye të justifikuara objektivisht ose ndalohet me ligj.” zëvendësohet me fjalinë “Ky informacion i jepet paguesit, aty ku është e mundur, përpara refuzimit të aksesit dhe jo më vonë se menjëherë pas refuzimit të tij, përveç rasteve kur dhënia e informacionit komprometon sigurinë për arsye objektive të justifikuara ose ndalohet me ligj.”.

Neni 48

Në pikën 1 të nenit 63 bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në shkronjën “c” pas fjalës “zhbllokimin” shtohen fjalët “e instrumentit të pagesës”.

2. Në shkronjën “d” togfjalëshi “sipas shkronjës “ç” të kësaj pike” zëvendësohet me fjalët “në përputhje me shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 62 të këtij ligji”.

Neni 49

Në pikën 1 të nenit 64 fjalët “afati i përcaktuar në nenin 1022 të Kodit Civil” zëvendësohen me fjalët “13 muaj pas datës së debitimit ”, si dhe hiqet fjalia “Ky afat fillon të llogaritet pas datës së debitimit.”.

Neni 50

Në pikën 4 të nenit 66 fjalët “si pasojë e pagesës” zëvendësohen me fjalët “si pasojë e rimbursimit”.

Neni 51

Në nenin 67 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 fjalët “deri në shumën maksimale prej 5 000 (pesë mijë) lekësh” zëvendësohen me fjalët “deri në vlerën ekuivalente në lekë të shumës maksimale prej 50 eurosh”.

2. Në shkronjën “b” të pikës 2 fjalët “të një subjekti tek i cili janë kontraktuar aktivitetet e tyre” zëvendësohen me fjalët “të palëve të treta me të cilët ka lidhur marrëveshje për transferimin e funksioneve operacionale”.

3. Në pikën 4 fjala “konsumatorit” zëvendësohet me fjalën “klientit”.

Neni 52

Në nenin 68 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) fjalët “në rastin e një pagese” zëvendësohen me fjalët “në rastin e një transaksioni pagese të”;

b) fjalët “shumën e fondeve” zëvendësohen me fjalët “shumën e saktë të fondeve”.

2. Në pikën 2 fjalët “apo të paktën” zëvendësohen me fjalët “dhe jo më vonë se”.

Neni 53

Në nenin 69 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Pa cenuar kërkesat e pikës 6 të këtij neni dhe krahas së drejtës për rimbursim, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, në rastin e debitimeve direkte të parashikuara në kuadrin nënligjor të Bankës së Shqipërisë për transfertat e kreditit dhe debitimin direkt dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, të debitimeve direkte të parashikuara në nenin 1, pika 1, të rregullores (BE) 260/2012, paguesi ka të drejtë të pakushtëzuar për rimbursim brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 70 të këtij ligji.”.

2. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Për debitimet direkte në monedha të tjera, përveç monedhës kombëtare lek dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, edhe përveç monedhës euro, Banka e Shqipërisë mund t’u kërkojë ofruesve të shërbimeve të pagesave të ofrojnë të drejta më të favorshme rimbursimi në përputhje me skemat e debitimeve direkte ku janë pjesëmarrës, me kusht që ato të jenë më të favorshme për paguesin.”.

Neni 54

Në nenin 70, pika 3, togfjalëshi “debitimit direkt” zëvendësohet me fjalët “debitimeve direkte të parashikuara në pikën 4 të nenit 69 të këtij ligji”.

Neni 55

Në pikën 4 të nenit 73 togfjalëshi “në pikën 2 ” zëvendësohet me togfjalëshin “në pikën 3”.

Neni 56

Në nenin 75 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Ky seksion zbatohet për:

a) transaksionet kombëtare të pagesave në monedhën lek;

b) transaksionet e pagesave kombëtare në euro dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, transaksionet e pagesave në euro;

c) transaksionet e pagesave që përfshijnë vetëm një këmbim monedhe ndërmjet monedhës euro dhe monedhës lek, me kusht që këmbimi i kërkuar i monedhës të kryhet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në rastin e transaksioneve ndërkufitare transferta ndërkufitare kryhet në monedhën euro. Kërkesat e kësaj shkronje në lidhje me transfertat ndërkufitare do të jenë të zbatueshme që nga momenti kur Shqipëria të jetë shtet anëtar.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Për transaksionet e pagesave me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, nëse përdoruesi i shërbimeve të pagesave dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave bien dakord për një periudhë më të gjatë se ajo e përcaktuar në nenin 76 të këtij ligji, kjo periudhë më e gjatë nuk tejkalon 4 ditë pune pas datës së marrjes së urdhërpagesës, sipas nenit 71 të këtij ligji.”.

Neni 57

Në pikën 3 të nenit 76 togfjalëshi “ndërmjet palëve” zëvendësohet me fjalët “ndërmjet përfituesit të pagesës dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave”.

Neni 58

Pika 2 e nenit 79 ndryshohet si më poshtë:

“2. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës siguron që shuma e transaksionit të pagesës është në dispozicion të përfituesit menjëherë pasi kjo shumë të jetë kredituar në llogarinë e ofruesit të shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës, kur nga ana e ofruesit të shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës:

a) nuk ka këmbim të monedhës; ose

b) ka këmbim midis monedhës lek dhe monedhës euro, ose ndërmjet monedhës lek dhe monedhës së një shteti anëtar, të ndryshme nga euro. Kërkesat e kësaj shkronje në lidhje me këmbimin midis monedhës lek dhe monedhës së një shteti anëtar, të ndryshme nga euro, do të jenë të zbatueshme që nga momenti kur Shqipëria të jetë shtet anëtar.”,

Neni 59

Titulli i seksionit 3 “Detyrimi” zëvendësohet me “Përgjegjësia”.

Neni 60

Në pikën 5 të nenit 81 fjala “rimbursimin” zëvendësohet me “rikuperimin”.

Neni 61

Në shkronjën “d” të pikës 2 të nenit 82 fjalët “sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni” zëvendësohen me fjalët “sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç” të kësaj pike”.

Neni 62

Kudo në pikën 1 të nenit 85 fjalët “sipas neneve 66 e 82 të këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “sipas neneve 66, 82 dhe 83 të këtij ligji”.

Neni 63

Në pikën 1 të nenit 87 fjalia e fundit “Përpunimi i të dhënave personale, për qëllime të këtij ligji, kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.” zëvendësohet me fjalinë “Dhënia e informacionit për individët lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe përpunimi i këtyre të dhënave personale, si dhe çdo përpunim tjetër i të dhënave personale për qëllime të këtij ligji kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.”.

Neni 64

Në nenin 88 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1 fjala “të mëdha” zëvendësohet me fjalën “madhore”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Parashikimet e pikës 1 të këtij neni nuk përjashtojnë zbatimin e kërkesave për administrimin e rrezikut të TIK-ut, të parashikuara në kuadrin nënligjor për qëndrueshmërinë operacionale digjitale dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, të kërkesave të kreut II të rregullores (BE) 2022/2554 për:

a) ofruesit e shërbimeve të pagesave, të parashikuar në shkronjat “a” deri në “f” të pikës 2 të nenit 3 të këtij ligji;

b) ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë, të parashikuar në nenin 28, pika 1, të këtij ligji;

c) institucionet e pagesave të përjashtuara sipas përcaktimeve të nenit 27, pika 1, të këtij ligji; dhe

ç) institucionet e parasë elektronike që përfitojnë nga përjashtimet, sipas përcaktimeve të nenit 28/8, pika 1, të këtij ligji.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Banka e Shqipërisë mund të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacion për rreziqet operacionale dhe të sigurisë të lidhura me shërbimet e pagesave, me autoritetet përgjegjëse të shteteve anëtare, Bankën Qendrore Evropiane dhe Autoritetin Bankar Evropian.”.

Neni 65

Në nenin 89 bëhen këto shtesa:

1. Në fund të pikës 3 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Banka e Shqipërisë, pas vlerësimit të rëndësisë dhe lidhjes së incidentit me autoritete të tjera vendase, i njofton këto të fundit për incidentin.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Banka e Shqipërisë, pas marrjes së njoftimit, sipas pikës 1 të këtij neni, pa vonesa të panevojshme, informon Autoritetin Bankar Evropian dhe Bankën Qendrore Evropiane në lidhje me detajet e incidentit. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me Autoritetin Bankar Evropian dhe Bankën Qendrore Evropiane për vlerësimin e rëndësisë dhe lidhjes së incidentit me autoritete të tjera vendase dhe të Bashkimit Evropian, të cilat njoftohen për incidentin. Mbi bazën e këtij njoftimi, Banka e Shqipërisë ose sipas rastit autoritetet e tjera marrin të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur sigurinë e menjëhershme të sistemit financiar.”.

3. Në fund të pikës 4 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, Banka e Shqipërisë do të përcjellë këto të dhëna në mënyrë të agreguar pranë Autoritetit Bankar Evropian dhe Bankës Qendrore Evropiane.”.

4. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Pikat 1 deri në 3/1 të këtij neni nuk do të zbatohen për subjektet e mëposhtme për të cilat do të zbatohen kërkesat përkatëse të parashikuara në kuadrin nënligjor për qëndrueshmërinë operacionale digjitale dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, në rregulloren (BE) 2022/2554:

a) ofruesit e shërbimeve të pagesave, të parashikuar në shkronjat “a” deri në “f” të pikës 2 të nenit 3 të këtij ligji;

b) ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë, të parashikuar në nenin 28, pika 1, të këtij ligji;

c) institucionet e pagesave të përjashtuara sipas përcaktimeve të nenit 27, pika 1, të këtij ligji;

ç) institucionet e parasë elektronike që përfitojnë nga përjashtimet, sipas përcaktimeve të nenit 28/8, pika 1, të këtij ligji.”.

Neni 66

Në pikën 5 të nenit 90 pas togfjalëshit “në përputhje me pikat 1 e 3 të këtij neni” shtohet fjala “dhe”.

Neni 67

Në shkronjën “ç” të pikës 1 të nenit 91 pas fjalëve “komunikimi të përbashkëta” shtohet fjala “të sigurta” dhe pas fjalëve “ofruesve të shërbimit të inicimit të pagesës” shtohen fjalët “ofruesve të shërbimit të informimit të llogarisë”.

Neni 68

Neni 92 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 92
Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve (ZAM)

1. Banka e Shqipërisë është autoriteti përgjegjës për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve pas një ankese të paraqitur nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave për shkelje të dispozitave të parashikuara në titujt III dhe IV të këtij ligji, nga ofruesit e shërbimeve të pagesave, të përcaktuar në pikën 29 të nenit 5 të këtij ligji, pas një ankese të paraqitur nga mbajtësit e parasë elektronike për shkelje të dispozitave të parashikuara në seksionit 2 të kreut II të titullit II këtij ligji, nga emetuesit e parasë elektronike, të përcaktuar në pikën 10/1 të nenit 5 të këtij ligji, si dhe për shkelje nga personat që përfitojnë nga përjashtimet sipas neneve 27, 28 dhe 28/8, të këtij ligji, si dhe nga agjentët ose degët e themeluara në Republikën e Shqipërisë nga ofrues të shërbimeve të pagesave ose emetues të parasë elektronike, në rastin kur Republika e Shqipërisë nuk është shteti anëtar i origjinës.

2. Banka e Shqipërisë, me qëllim zbatimin e kërkesave të pikës 1 të këtij neni, krijon një njësi të veçantë për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM), e cila shqyrton dhe zgjidh mosmarrëveshjet sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit. Vendimi i strukturës ZAM ka efekte juridike të përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorit.

3. Banka e Shqipërisë me akt nënligjor miraton rregullat për funksionimin dhe organizimin e njësisë ZAM, në përputhje me parashikimet e legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit.

4. Banka e Shqipërisë me akt nënligjor miraton procedurat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve nga ana e njësisë ZAM, në përputhje me parashikimet e legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit. Procedurat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve të përcaktuara në

pikën 1 të këtij neni, lidhur me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga titujt III e IV dhe nga seksioni 2 i kreut II të titullit II të këtij ligji duhet të jenë të përshtatshme, të pavarura, të paanshme, transparente dhe efektive.

5. Procedurat e ZAM-it, sipas pikës 4 të këtij neni, zbatohen për ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe emetuesit e parasë elektronike dhe gjithashtu mbulojnë edhe veprimtaritë e personave që administrojnë biznesin e tyre.

6. Banka e Shqipërisë publikon procedurat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve në faqen e internetit të saj.

7. Banka e Shqipërisë do të bashkëpunojë efektivisht me autoritetet përgjegjëse në shtetet e tjera anëtare për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkufitare në lidhje me të drejtat dhe detyrimet sipas titujve III dhe IV dhe seksionit 2 të kreut II të titullit II të këtij ligji.”.

Neni 69

Në nenin 93 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 2 shtohen fjalët “si dhe monitorojnë performancën e këtyre procedurave.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Procedurat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni vihen në dispozicion, në gjuhën shqipe ose në një gjuhë tjetër, nëse është rënë dakord shprehimisht ndërmjet ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe përdoruesit të shërbimeve të pagesave.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Procedurat e përmendura në pikën 2 të këtij neni zbatohen në çdo shtet anëtar ku ofruesi i shërbimeve të pagesave ofron shërbimet e pagesave dhe vihen në dispozicion, në një gjuhë zyrtare të shtetit anëtar përkatës, ose në një gjuhë tjetër, nëse është rënë dakord shprehimisht ndërmjet ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe përdoruesit të shërbimeve të pagesave.”.

4. Në pikën 4 fjalët “ndërmjet palëve” zëvendësohen me fjalët “ndërmjet ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe përdoruesit të shërbimeve të pagesave”.

5. Pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. E drejta për të paraqitur padi në gjykatë nuk ndikohet nga procedurat e parashikuara në këtë nen.”.

Neni 70

Neni 94 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 94

Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij konsiderohen si kundërvajtje administrative dhe Banka e Shqipërisë ka të drejtë të

vendosë gjoba ndaj ofruesit të shërbimeve të pagesave, emetuesit të parasë elektronike, ose kundrejt atyre që efektivisht kontrollojnë e administrojnë veprimtarinë e tyre. Gjobat duhet të jenë efektive, proporcionale dhe të shërbejnë si masë parandaluese për shkelje të tjera.

2. Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë për institucionin e pagesave dhe, kur është e zbatueshme, për personin fizik ose juridik që përfiton nga përjashtimi, sipas neneve 27 ose 28 të këtij ligji, kur kryen shkeljet e mëposhtme:

a) ofron shërbime të pagesave të papërfshira në licencë ose të paregjistruara, sipas neneve 6 e 16 të këtij ligji;

b) nuk plotëson kërkesat e parashikuara në nenin 6/1 të këtij ligji;

c) nuk plotëson kërkesat për fondet e veta, siç parashikohet në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij;

ç) nuk mbron fondet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave në kundërshtim me nenin 12 të këtij ligji;

d) përdor fondet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave të ruajtura sipas përcaktimeve të nenit 12, shkronja “a”, të këtij ligji për qëllime të tjera nga mbrojtja e fondeve;

dh) nuk ka krijuar rregulla, procedura dhe sisteme të përshtatshme dhe gjithëpërfshirëse për drejtimin e kontrollin e brendshëm, siç parashikohet në pikën 4 të nenit 13 të këtij ligji;

e) nuk njofton Bankën e Shqipërisë për faktet ose rrethanat e reja të konstatuara pas dhënies së licencës në kundërshtim me nenin 17 të këtij ligji;

ë) nuk mban llogaritë kontabël e nuk përgatit raportet financiare për pasqyrimin e gjendjes financiare, në mënyrë të saktë dhe në përputhje me rregullat e parimet kontabël, siç parashikohet në nenin 18 të këtij ligji;

f) në rastet kur institucioni i pagesave kryen edhe veprimtari të tjera, të ndryshme nga ato të shërbimeve të pagesave, nuk mban informacion të veçantë kontabël, siç parashikohet në pikën 4 të nenit 18 të këtij ligji;

g) nuk raporton sipas formës, tipit, metodologjisë, përmbajtjes dhe afateve të përcaktuara në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, siç parashikohet në nenin 18 të këtij ligji;

gj) jep kredi lidhur me shërbimet e pagesave në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në pikën 4 të nenit 19 të këtij ligji dhe nuk zbaton kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve, siç parashikohet në pikën 6 të nenit 19 të këtij ligji;

h) krijon një degë në një shtet tjetër anëtar pa miratimin e Bankës së Shqipërisë, siç parashikohet në nenin 21, pika 4/1, të këtij ligji;

i) ofron shërbimin e pagesave nëpërmjet agjentëve pa njoftuar Bankën e Shqipërisë, siç parashikohet në pikën 1 të nenit 21 të këtij ligji;

j) nuk informon Bankën e Shqipërisë për transferimin e funksioneve operacionale të shërbimit të pagesave tek të tretët, siç parashikohet në pikën 6 të nenit 21 të këtij ligji;

k) lidh marrëveshje me të tretët për transferimin e funksioneve të rëndësishme operacionale në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në nenin 21, pika 9, të këtij ligji;

l) nuk siguron që agjentët ose degët që veprojnë për llogari të tij të informojnë përdoruesit e shërbimeve të pagesave se për cilin institucion pagesash veprojnë, në zbatim të kërkesave të nenit 21, pika 10, të këtij ligji;

ll) nuk njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim lidhur me marrëveshjet me të tretët dhe me agjentët, siç parashikohet në nenin 21, pika 11, të këtij ligji;

m) ofron shërbime pagesash në territorin e një shteti tjetër anëtar, pa njoftuar paraprakisht Bankën e Shqipërisë, siç parashikohet në nenin 26/3, pika 1, të këtij ligji;

n) ofron shërbime pagesash në territorin e një vendi të tretë, pa miratimin e Bankës së Shqipërisë, siç parashikohet në nenin 26/8 të këtij ligji;

nj) nuk plotëson kërkesat e akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë, të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

3. Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë për institucionin e parasë elektronike dhe, kur është e zbatueshme, për personat që përfitojnë nga përjashtimi, sipas nenit 28/8 të këtij ligji, kur kryen shkeljet e mëposhtme:

a) nuk plotëson kërkesat e parashikuara në nenin 6/1 të këtij ligji;

b) nuk mbron fondet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave në kundërshtim me nenin 12 të këtij ligji;

c) përdor fondet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave të ruajtura sipas përcaktimeve të nenit 12, shkronja “a”, të këtij ligji, për qëllime të tjera nga mbrojtja e fondeve;

ç) nuk ka krijuar rregulla, procedura dhe sisteme të përshtatshme dhe gjithëpërfshirëse për drejtimin e kontrollin e brendshëm, siç parashikohet në pikën 4 të nenit 13 të këtij ligji;

d) nuk njofton Bankën e Shqipërisë për faktet ose rrethanat e reja të konstatuara pas dhënies së licencës në kundërshtim me nenin 17 të këtij ligji;

dh) nuk mban llogaritë kontabël e nuk përgatit raportet financiare për pasqyrimin e gjendjes financiare, në mënyrë të saktë dhe në përputhje me rregullat e parimet kontabël, siç parashikohet në nenin 18 të këtij ligji;

e) në rastet kur institucioni i parasë elektronike kryen edhe veprimtari të tjera të ndryshme nga emetimi i parasë elektronike, nuk mban informacion të veçantë kontabël, siç parashikohet në nenin 18 të këtij ligji;

ë) nuk raporton sipas formës, tipit, metodologjisë, përmbajtjes dhe afateve të përcaktuara në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, siç parashikohet në nenin 18 të këtij ligji;

f) nuk informon Bankën e Shqipërisë për transferimin e funksioneve operacionale tek të tretët, siç parashikohet në pikën 6 të nenit 21 të këtij ligji;

g) lidh marrëveshje me të tretët për transferimin e funksioneve të rëndësishme operacionale në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në nenin 21, pika 9, të këtij ligji;

gj) nuk njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim lidhur me marrëveshjet me të tretët, siç parashikohet në nenin 21, pika 11, të këtij ligji;

h) nuk informon paraprakisht Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim të rëndësishëm, në masat e ndërmarra për mbrojtjen e fondeve të pranuara në këmbim të emetimit të parasë elektronike, në kundërshtim me nenin 28/5, pika 6, të këtij ligji;

i) emeton para elektronike nëpërmjet agjentëve në kundërshtim me nenin 28/1, pika 9, të këtij ligji;

j) ofron shërbime pagesash nëpërmjet agjentëve pa njoftuar Bankën e Shqipërisë, siç parashikohet në pikën 1 të nenit 21 të këtij ligji në kundërshtim me parashikimet e nenit 28/1, pika 9, të këtij ligji;

k) nuk plotëson kërkesat për kapitalin minimal, siç parashikohet në nenin 28/2 të këtij ligji;

l) jep kredi lidhur me shërbimet e pagesave, pa plotësuar kushtet e parashikuara në pikat 4 dhe 6 të nenit 19 të këtij ligji, në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në pikën 1 të nenit 28/4 të këtij ligji;

ll) jep kredi lidhur me shërbimet e pagesave nga fondet e marra në këmbim të emetimit të parasë elektronike në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në pikën 2 të nenit 28/4 të këtij ligji;

m) nuk shkëmben fondet e marra nga mbajtësi i parasë elektronike me para elektronike në kundërshtim me parashikimet e nenit 28/4, pika 4, të këtij ligji;

n) nuk mbron fondet e marra në këmbim të parasë elektronike të emetuar, në përputhje me nenin 28/5 të këtij ligji;

nj) krijon një degë në një shtet tjetër anëtar ose në një vend të tretë, pa miratimin e Bankës së Shqipërisë siç parashikohet në nenin 21, pika 4/1, ose në nenin 28/7 të këtij ligji;

o) nuk plotëson kërkesat e akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë, të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

4. Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë për ofruesin e shërbimeve të pagesave, kur kryen shkeljet e mëposhtme:

a) tarifon përdoruesin e shërbimeve të pagesave për dhënien e informacionit në kundërshtim me nenin 33 të këtij ligji;

b) nuk i siguron përdoruesit të shërbimeve të pagesave informacionin për karakteristikat e shërbimeve të pagesave për instrumentet e pagesave me vlerë të vogël, të kryera sipas kontratës tip, të parashikuar në nenin 35 të këtij ligji;

c) nuk i siguron përdoruesit të shërbimeve të pagesave informacionin e përgjithshëm për transaksionet individuale të pagesës, të parashikuar në nenet 37 deri 42 të këtij ligji, ose nuk e siguron informacionin sipas mënyrës së përcaktuar në këto nene;

ç) nuk i siguron përdoruesit të shërbimeve të pagesave informacionin e përgjithshëm për transaksionet e pagesave të kryera sipas kontratës tip, të parashikuar në nenet 44 deri 47 të këtij ligji, ose nuk e siguron informacionin sipas mënyrës së përcaktuar në këto nene;

d) tarifon përdoruesin e shërbimeve të pagesave në rastin e zgjidhjes së kontratës tip në kundërshtim me nenin 48 të këtij ligji;

dh) nuk i siguron paguesit informacionin për transaksionin individual të pagesës, të parashikuar në nenin 50 të këtij ligji, ose nuk i siguron përfituesit të pagesës informacionin për transaksionin individual të pagesës, të parashikuar në nenin 51 të këtij ligji;

e) nuk i siguron paguesit informacionin për tarifat e kursin e këmbimit, të parashikuar në nenin 52 të këtij ligji;

ë) nuk informon përdoruesin e shërbimeve të pagesave përpara inicimit të transaksionit të pagesës për tarifën e përdorimit të një instrumenti pagese, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 53 të këtij ligji;

f) nuk ekzekuton transaksionin e pagesës pas marrjes së urdhërpagesës në kundërshtim me nenin 71 të këtij ligji;

g) nuk informon përdoruesin e shërbimeve të pagesave për refuzimin e ekzekutimit të urdhërpagesës, sipas parashikimeve në pikat 1 dhe 2 të nenit 72 të këtij ligji;

gj) nuk lejon përdoruesin e shërbimeve të pagesave të revokojë urdhërpagesën, siç parashikohet në nenin 73 të këtij ligji;

h) nuk transferon shumën e plotë të transaksionit të pagesës, siç parashikohet në pikën 1 të nenit 74 të këtij ligji, ose në rastet kur palët kanë rënë dakord për zbritjen e tarifave nga shuma e transferuar, nuk informon përfituesin për shumën e plotë të transaksionit të pagesës dhe tarifat e zbritura, siç parashikohet në pikën 2 të nenit 74 të këtij ligji;

i) nuk zbaton kërkesat për ekzekutimin e transfertave të kreditit dhe të debitimit direkt, sipas përcaktimeve të nenit 75 të këtij ligji;

j) nuk ekzekuton transaksionin e pagesës brenda afateve kohore të parashikuara në nenin 76 të këtij ligji;

k) nuk transmeton urdhërpagesën e iniciuar nga ose nëpërmjet përfituesit të pagesës tek ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit brenda afateve kohore të rëna dakord ndërmjet palëve, në mënyrë që transaksioni i pagesës të ekzekutohet në ditën e caktuar, siç parashikohet në pikën 3 të nenit 76 të këtij ligji;

l) nuk vendos fondet në dispozicion të përfituesit të pagesës brenda afateve kohore të përcaktuara në nenet 77 deri në 79 të këtij ligji;

ll) nuk rimburson shumën e transaksionit të pagesës së paekzekutuar ose të ekzekutuar në mënyrë të gabuar, si dhe tarifat ose interesat përkatëse siç parashikohen në nenin 82 të këtij ligji;

m) nuk krijon një kuadër rregullativ me masat e duhura zbutëse dhe mekanizma kontrolli për administrimin e rreziqeve operacionale dhe të sigurisë, siç parashikohet në nenin 88, pika 1, të këtij ligji;

n) nuk i paraqet Bankës së Shqipërisë vlerësim të përditësuar të rreziqeve operacionale dhe të sigurisë, masave zbutëse dhe mekanizmave të kontrollit, siç parashikohet në nenin 88, pika 2, të këtij ligji;

nj) nuk njofton Bankën e Shqipërisë në rast se ndodh një incident madhor operacional apo i sigurisë, siç parashikohet në nenin 89, pika 1, të këtij ligji;

o) nuk ka njoftuar përdoruesit e shërbimeve të pagesave për incidentin, siç parashikohet në nenin 89, pika 2, të këtij ligji;

p) nuk siguron të dhëna statistikore për mashtrimet lidhur me mjetet e ndryshme të pagesës dhe nuk i raporton këto të dhëna në Bankën e Shqipërisë, siç parashikohet në nenin 89, pika 4, të këtij ligji;

q) nuk zbaton autentifikim të thelluar të klientit, siç parashikohet në nenin 90 të këtij ligji;

r) nuk respekton kërkesat për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave, në kundërshtim me përcaktimet e këtij ligji;

rr) nuk përcakton procedurat ose rregullat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, lidhur me ofrimin e shërbimeve të pagesave ose nëse këto procedura ose rregulla nuk përmbushin kërkesat e parashikuara në këtë ligj;

s) nuk plotëson kërkesat e akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë, të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

5. Në rastet e shkeljeve të aktit nënligjor për tarifat e shkëmbimit, të parashikuar në nenin 55, pika 5, të këtij ligji dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, të rregullores (BE) 2015/751, Banka e Shqipërisë kërkon eliminimin e shkeljeve të konstatuara, përcakton afatin për paraqitjen e provave përkatëse për eliminimin e këtyre shkeljeve, si dhe vendos gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë për emetuesin ose pranuesin e instrumentit të pagesës, në rastet kur ai:

a) aplikon tarifa shkëmbimi në kundërshtim me aktin nënligjor të Bankës së Shqipërisë për tarifat e shkëmbimit dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, në kundërshtim me nenet 3 dhe 4 të rregullores (BE) 2015/751;

b) refuzon lëshimin e instrumentit të pagesës me kartë, sipas kushteve të përcaktuara në aktin nënligjor të Bankës së Shqipërisë për tarifat e shkëmbimit dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, në nenin 8 të rregullores (BE) 2015/751;

c) nuk i jep konsumatorit informacion të qartë dhe objektiv për markat dhe karakteristikat e instrumentit të pagesës me kartë, sipas kërkesave të këtij ligji dhe aktit nënligjor të Bankës së Shqipërisë për tarifat e shkëmbimit dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, të nenit 8 të rregullores (BE) 2015/751;

ç) përdor mekanizma ose pajisje që kufizojnë zgjedhjen e markës ose aplikacionit të pagesës, në kundërshtim me aktin nënligjor të Bankës së Shqipërisë për tarifat e shkëmbimit dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, në kundërshtim me nenin 8 të rregullores (BE) 2015/751;

d) nuk aplikon tarifat e shërbimit të tregtarit në mënyrë transparente dhe të ndarë sipas kategorive të kartave, në kundërshtim me aktin nënligjor të Bankës së Shqipërisë për tarifat e shkëmbimit dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, në kundërshtim me nenin 9 të rregullores (BE) 2015/751;

dh) nuk përfshin në kontratën me tregtarin informacionin për të gjitha tarifat e aplikueshme, në kundërshtim me aktin nënligjor të Bankës së Shqipërisë për tarifat e shkëmbimit dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, në kundërshtim me nenin 9 të rregullores (BE) 2015/751;

e) detyron tregtarin të pranojë instrumente të tjera pagese, në kundërshtim me aktin nënligjor të Bankës së Shqipërisë për tarifat e shkëmbimit dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, në kundërshtim me nenin 10 të rregullores (BE) 2015/751;

ë) nuk siguron identifikueshmërinë elektronike dhe vizuale të instrumentit të pagesës me kartë, në kundërshtim me aktin nënligjor të Bankës së Shqipërisë për tarifat e shkëmbimit dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, në kundërshtim me nenin 10 të rregullores (BE) 2015/751;

f) kufizon të drejtën e tregtarit për të orientuar konsumatorin për zgjedhjen e instrumentit të pagesës, në kundërshtim me aktin nënligjor të Bankës së Shqipërisë për tarifat e shkëmbimit dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, në kundërshtim me nenin 11 të rregullores (BE) 2015/751;

g) nuk i dorëzon tregtarit informacionin e kërkuar për transaksionin dhe tarifat përkatëse brenda afateve të caktuara në aktin nënligjor të Bankës së Shqipërisë për tarifat e shkëmbimit dhe, kur Shqipëria të jetë shtet anëtar, në nenin 12 të rregullores (BE) 2015/751.

6. Në rast se emetuesi ose pranuesi i instrumentit të pagesës së bazuar në kartë nuk paraqet brenda afatit të përcaktuar provat që vërtetojnë eliminimin e shkeljeve dhe parregullsive, siç parashikohet në pikën 5 të këtij neni, Banka e Shqipërisë vendos përsëri gjobë në shumën maksimale të parashikuar në pikën 5 të këtij neni.

7. Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë për emetuesin e parasë elektronike, kur kryen shkeljet e mëposhtme:

a) nuk plotëson kërkesat e parashikuara në nenin 28/10 të këtij ligji në lidhje me emetimin e parasë elektronike ose ripagimin e fondeve;

b) i paguan interes ose ndonjë përfitim tjetër mbajtësit të parasë elektronike për periudhën gjatë së cilës ky i fundit e mban paranë elektronike në kundërshtim me parashikimet e nenit 28/11 të këtij ligji;

c) nuk përcakton procedurat ose rregullat për trajtimin e ankesave dhe zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve ose nëse këto procedura ose rregulla nuk përmbushin kërkesat e parashikuara në këtë ligj;

ç) nuk plotëson kërkesat e akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë, të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

8. Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë, kur konstaton shkeljet e mëposhtme:

a) për pjesëmarrësin në një sistem pagesash, në rast se vepron në kundërshtim me parashikimet e pikës 3 të nenit 29 të këtij ligji;

b) për pjesëmarrësin në një sistem pagesash që funksionon sipas parimit të finalitetit të shlyerjes, në rast se nuk plotëson kërkesat e nenit 29/1 të këtij ligji;

c) për bankën, në rast se vepron në kundërshtim me parashikimet e nenit 30 të këtij ligji.

9. Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë, kur ofruesi i shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë kryen shkeljet e mëposhtme:

a) nuk i konfirmon menjëherë ofruesit të shërbimeve të pagesave nëse shuma e nevojshme për ekzekutimin e transaksionit të pagesës me kartë (*card-based*) është e disponueshme në llogarinë e pagesës së paguesit, siç parashikohet në nenin 58 të këtij ligji;

b) nuk ofron informacionin e nevojshëm për realizimin e një transaksioni që iniciohet nëpërmjet një ofruesi për shërbimin e inicimit të pagesës, në kundërshtim me parashikimet e nenit 59 të këtij ligji;

c) nuk ofron informacionin e nevojshëm për ofruesin e shërbimit për informimin e llogarisë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 60 të këtij ligji.

10. Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë për ofruesin e shërbimeve të pagesave që përfiton nga përjashtimi, sipas neneve 27 ose 28 të këtij ligji, nëse nuk njofton Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim të situatës së tij, që ndikon në përmbushjen e kushteve për të përfituar nga përjashtimi.

11. Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë për personin që përfiton nga përjashtimi, sipas nenit 28/8 të këtij ligji, nëse nuk njofton Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim të situatës së tij, që ndikon në përmbushjen e kushteve për të përfituar nga përjashtimi.

12. Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë për punonjësit përgjegjës për shkeljet e parashikuara në pikat 2 deri në 7 të këtij neni.

13.Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 20 000 (njëzet mijë) lekë deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë për administratorin e institucionit të pagesave, administratorin e institucionit të parasë elektronike ose për personin përgjegjës për drejtimin, lidhur me shërbimet e pagesave ose me emetimin e parasë elektronike, në rast se nuk i paraqet Bankës së Shqipërisë informacionin e nevojshëm sipas formës dhe afatit kohor të kërkuar, siç parashikohet në pikën 2 të nenit 25 të këtij ligji.

14. Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 5 000 (pesë mijë) lekë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë për punonjësin përgjegjës për shkeljen e parashikuar në pikën 13 të këtij neni.

15. Banka e Shqipërisë, përveç rasteve të shfuqizimit të licencës sipas pikës 1 të nenit 15 dhe pezullimit të një ose disa veprimtarive sipas shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 25 të këtij ligji, kur e gjykon të arsyeshme, mund të pezullojë një ose disa veprimtari apo të shfuqizojë licencën e institucionit të pagesës ose institucionit të parasë elektronike, në rastet kur kërkohet nga autoritetet kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

16. Në përcaktimin e masës së gjobës, sipas pikave 2 deri në 14 të këtij neni, Banka e Shqipërisë mban në konsideratë:

a) rrethanat në të cilat është kryer shkelja;

b) pasojat e shkeljes;

c) përsëritjen e shkeljes;

ç) rëndësinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes.

17. E drejta për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative të parashikuara në këtë nen nuk mund të ushtrohet kur kanë kaluar 3 vjet nga çasti i kryerjes së kundërvajtjes administrative.

18. Në rastin e përsëritjes së shkeljeve ose në rast se gjoba nuk paguhet brenda afatit dhe sipas procedurës së përcaktuar në legjislacionin "Për kundërvajtjet administrative", Banka e Shqipërisë vendos dyfishimin e gjobës.

Në rast se shkeljet përsëriten dhe gjoba sërish nuk paguhet brenda afatit, atëherë Banka e Shqipërisë vendos të pezullojë ushtrimin e një ose disa veprimtarive për një periudhë 6-mujore.

Në vendimin për pezullimin e ushtrimit të një ose disa veprimtarive, Banka e Shqipërisë ngarkon subjektin/personin me pagimin e të gjitha detyrimeve të prapambetura dhe me plotësimin e të gjitha të metave të konstatuara. Në rast se pas plotësimit të afatit 6-mujor të pezullimit Banka e Shqipërisë vlerëson se subjekti nuk i ka plotësuar të gjitha detyrimet e parashikuara më sipër në këtë pikë, atëherë ajo vendos për shfuqizimin e licencës.

19. Gjobat e vendosura sipas këtij ligji arkëtohen për llogari të Bankës së Shqipërisë.

20. Gjobat e vendosura sipas këtij ligji janë tituj ekzekutivë dhe me ekzekutimin e tyre ngarkohet Shërbimi Përmbarimor.".

Neni 71

Në pikën 1 të nenit 96 pas fjalëve "çdo institucion pagese" shtohen fjalët "institucion i parasë elektronike, ose person".

Neni 72

Në pikën 1 të nenit 97 pas fjalëve "çdo institucion pagese" shtohen fjalët "institucion i parasë elektronike, ose person".

Neni 73

Në nenin 101 bëhet ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Paragrafi i parë numërtohet pika 1.

2. Pas pikës 1 shtohen pikat 2, 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:

"2. Neni 10, pika 3; neni 13, pika 2/1 dhe pika 9; neni 16, pikat 1/1, 5, 6, 7 dhe 8; neni 21, pika 4/1; neni 26/1, pika 1 dhe 2; nenet 26/2 deri 26/6; neni 27, pika 7; neni 28/1, pika 8; neni 28/3, pika 10; neni 28/6, pika 6; neni 28/8, pika 9; neni 31, pika 5;

neni 88, pika 4; neni 89, pika 3/1; neni 92, pika 7; neni 93, pika 3/1 dhe neni 94, pika 2, shkronja “h” dhe “m” dhe pika 3, shkronja “nj”, të këtij ligji, hyjnë në fuqi me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

3. Në nenin 5, pika 7, dhe në nenin 16, pika 1/1, të këtij ligji, kërkesat që lidhen me konceptin e shtetit anëtar do të hyjnë në fuqi me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

4. Për qëllimet e pikës 2 të nenit 31 të këtij ligji, deri në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian zbatohen vlerat përkatëse prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh. Nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, kjo vlerë zëvendësohet automatikisht me vlerën ekuivalente në lekë të shumës 1 milion euro, sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës të Bashkimit Evropian.”.

Neni 74

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në datën 1 janar 2027.

Miratuar në datën 22.10.2026

Shpallur me dekretin nr. 582, datë 31.10.2026 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj